



Perspektiva Gjinore në Tekstet Shkollore

Udhëzues për shtëpitë botuese
të teksteve shkollore

Tiranë, korrik 2008



KVINNA TILL KVINNA

Ky studim botohet në kuadrin e projektit “Nxitja e Kurrikulës së Ndjeshme Gjinore për Shkollën nëntëvjeçare dhe të mesme”, i financuar nga: Sida - Swedish International Development Cooperation Agency, nëpërmjet organizatës suedeze Kvinna till Kvinna. Opinionet, konkluzionet apo rekomandimet e shprehura në këtë material, i përkasin autoreve dhe jo qeverisë suedeze.

Grupi i punës:

Prof. As. Dr. Milika Dhamo
Prof. As. Dr. Marjana Sinani
Dr. Eglantina Gjermeni
Daniela Kalaja, MA

Recensent: Agim Sinani

Redaktore shkencore: Yllka Spahiu, MA

Koordinatorë projekti: Elvana Lula, M.S.W.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për qendrën
“Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Adresa:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
Kutia postare 2418, Tiranë
Tel. & Fax: (355) 4 2255514/5
E-mail: qdi@gadc-al.org
Faqja e internetit: <http://www.gadc-al.org>

Faqësja: Studio Grafike “Elsi Kongo”
Shtypur në Shtypshkronjën PEGI

Hyrje

Një vështrim kronologjik i përpjekjeve për integrimin gjinor në arsim

Ky udhëzues është një tjetër përpjekje e “Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim” në kuadër të integritit gjinor në arsim, i cili njihet në mbarë botën si një tregues i rëndësishëm i zhvillimit social dhe ekonomik të një shoqërie. Në këtë vështrim, niveli arsimor është, gjithashtu, një tregues që flet për statusin e grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare. Të dhënat statistikore tregojnë se në të gjitha nivelet e arsimit vajzat të ne janë më të suksesshme se djemtë. Por, megjithëse ato përbëjnë numrin më të madh të regjistrimeve dhe diplomimeve, si dhe japin një kontribut të rëndësishëm në fushën e arsimit, statusi i tyre social dhe ekonomik lë shumë për të dëshiruar.¹

Arsimi i grave është veçanërisht i rëndësishëm nëse marrim në konsideratë rolin e tyre riprodhues social. Gratë e arsimuara kanë familje më të vogla dhe më pak fëmijë që vdesin gjatë lindjes; ata që mbijetojnë janë më të shëndetshëm dhe më të mirëarsimuar. Për më tepër, gratë e arsimuara janë më të përgatitura për të hyrë në tregun e punës.²

Arsimimi i vajzave/ grave redukton transmetimin e varfërisë nga brezi në brez dhe rrit kapacitetin e tyre me qëllim socializimin e brezit të ardhshëm, si potencialet e tyre për të kontribuar në aspektet sociale, ekonomike dhe politike të zhvillimit kombëtar. Për këtë arsye shtohet nevoja për realizimin e studimeve në këtë fushë.³ Nëpërmjet arsimit mund të minimizohen pabarazitë midis burrave dhe grave, si dhe midis grupeve të tjera shoqërore. Realiteti tregon se në sektorin e arsimit ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme gjinore. Kërkimet e fundit mbi përkatësinë gjinore dhe arsimin kanë nxjerrë se në shumë vende duke përfshirë edhe Shqipërinë, arsimi me aspektet e tij të shumta si korniza kurrikulare, arritjet akademike në shkollë, frekuentimi i shkollës, trajnimi i mësuesve, mjedisi institucional, etj., luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen apo transmetimin e pabarazive gjinore.

Puna për përgatitjen e këtij udhëzuesi nuk është e rastësishme. Përpara se të mbërrinte deri këtu, “Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim” ka zbatuar një sërë projektesh dhe veprimtarish, si: trajnime me mësues të të gjitha niveleve dhe lektorë universitetesh; botime të ndryshme lidhur me përfshirjen e perspektivës gjinore në arsim. Megjithatë, dy janë iniciativat më domethënëse:

¹ Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri. 2005.

² UNDP 2005. Toward universal primary education: Investments, incentives, and institutions, Achieving the Millennium Development Goals, Task Force in Education. P.21.

³ Po aty, faqe 26.

1. “Analiza gjinore e teksteve të shkollës fillore”

Ky studim u përgatit dhe u botua në kuadrin e projektit “Zhvillimi dhe Forcimi i Kapaciteteve për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Arsim”.⁴ Analiza e teksteve është realizuar duke u mbështetur në metoda cilësore dhe sasiore. Kur ka qenë e mundur dhe e arsyeshme, janë përdorur metoda tipike të studimit të përvojës njerëzore, siç janë metodat komplekse të analizës së rrëfimit, analizës së përmbajtjes, analizës semiotike, etj. Të gjitha parashtrimet, analizat, trajtimet, pyetjet, shembujt, udhëzimet, që autorët kanë konsideruar “ftesë për vëmendje”, kanë pasur pikënisje analizën e teksteve të ciklit fillor, në aspektin e perspektivës gjinore. Nga kjo analizë janë konstatuar dukshëm probleme, të cilat meritojnë vëmendje dhe reflektim nga të gjithë aktorët e sistemit arsimor, përfshirë këtu edhe stafet e shtëpive botuese, të cilat prodhojnë tekstet.

2. “Paketa Burimore mbi Përkatësinë Gjinore për Mësuesit e Ciklit Fillor”

Si një vazhdimësi e përpjekjeve për integrimin gjinor në arsim, krijimi i “Paketës Burimore mbi Përkatësinë Gjinore për Mësuesit e Ciklit Fillor” u realizua nga “Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim” në kuadrin e projektit “Paketë Burimore për Mësuesit e Ardhshëm”.⁵ “Paketa Burimore mbi Përkatësinë Gjinore për Mësuesit e Ciklit Fillor”, iu adresua studentëve të fakulteteve të mësuesisë, që janë në proces përgatitjeje për të ushtruar profesionin e mësuesit/es në ciklin fillor. Kjo paketë burimore përmban 10 module për çështjet e përkatësisë gjinore sipas lëndëve të ciklit fillor, si: matematika, leximi, dituria e natyrës, historia, gjuha, etj.

“Paketa Burimore mbi Përkatësinë Gjinore për Mësuesit e Ciklit Fillor”, tërthorazi ka si audiencë edhe nxënësit e ciklit fillor. Kjo sepse modulet janë hartuar, mbi bazën e teksteve aktuale të këtij cikli dhe synojnë familjarizimin e nxënësve me termat, konceptet dhe frymën gjinore. Të gjitha trajtimet, analizat, pyetjet dhe refleksionet, që gjenden në këtë material kanë si pikënisje pikërisht këto tekste.

Sigurisht, përpjekjet e “Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim” për integrimin gjinor në arsim nuk përfundojnë këtu. Përgatitja e këtij udhëzuesi është i pari kontribut, i cili synon t’u vijë në ndihmë shtëpive botuese të teksteve shkollore në përgatitjen e teksteve që ofrojnë perspektiva gjinore të ekuilibruara dhe socializim të shëndetshëm.

⁴ I financuar nga: Sida - Swedish International Development Cooperation Agency, nëpërmjet organizatës suedeze Kvinna till Kvinna.

⁵ E njëjtë si më sipër.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje

Një vështrim kronologjik i përpjekjeve për integrimin gjinor në arsim 3

I. Argumente për hartimin e udhëzuesit 7

1.1. Pse hartohet ky udhëzues? 7

1.2. Qëllimi dhe objektivat e këtij udhëzuesi 8

1.3. Kujt i drejtohet ky udhëzues? 9

II. Edukimi gjinor 14

2.1. Metodologjia 15

2.2. “Gracka” të deformimit gjinor 15

2.3. Konteksti global dhe edukimi gjinor 18

2.3.1. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit 18

2.3.2. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) 19

2.3.3. Konferenca e Pekinit-plafroma për Veprim 19

2.3.4. Konferenca e Kombeve të Bashkuara Pekin + 10 20

2.4. Konteksti kombëtar dhe edukimi gjinor 20

2.4.1. Kushtetuta e Shqipërisë 20

2.4.2. Ligji për Arsimin Parauniversitar 20

2.4.3. Ligji “Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë” 20

2.4.4. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Pjesa e Arsimit 21

2.5. Apeli për zhvillim të dimensionit gjinor në tekste 21

III. Tekstet mësimore në këndvështrimin gjinor 23

3.1. Sjellja dhe stereotipat gjinorë në tekstet e analizuar 25

3.1.2. Stereotipizimi Gjinor 27

3.1.3. <i>Lidershipi</i>	29
3.1.4. <i>Skena tipike të formimit të roleve gjinore</i>	29
3.1.5. <i>Autoriteti gjinor</i>	30
3.1.6. <i>Mbizotërimi gjinor i roleve sociale</i>	30
3.1.7. <i>Ilustrimet</i>	31
3.1.8. <i>Skemat e të menduarit dhe sjellja</i>	32
3.2. Perspektiva gjinore në teskte-si dhe ku?	33
3.3. Përditësimi i dimensionit androgjenik në përvojën vetjake	36
IV. Rekomandime për shtëpitë botuese të teksteve shkollore	38
4.1. Vizibiliteti/Dukshmëria	38
4.2. Stereotipat	38
4.3. Marrëdhëniet	39
4.4. Profesionet	39
4.5. Detyra praktike	40
4.6. Aparati pedagogjik i tekstit	40
4.7. Listë kontrolli për autorët gjatë procesit të hartimit të teksteve mësimore	42
4.8. Listë kontrolli për ilustruesit gjatë procesit të hartimit të teksteve mësimore	43
4.9. Listë kontrolli për redaktorët shkencorë gjatë hartimit dhe redaktimit të teksteve mësimore	44
Përfundime	45
Referencat	46
V. Anekse	47
Aneks 5.1. Kontrata tip	47
Aneks 5.2. Udhëzues vlerësimi për tekstet mësimore	52
Aneks 5.3. Koncepte të tjera dhe Përkufizime mbi Përkatësinë Gjinore dhe Zhvillimin	62

I. Argumente për hartimin e udhëzuesit

1.1. Pse hartohet ky udhëzues?

Arsimi njihet në mbarë botën si me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin social dhe ekonomik të një shoqërie qytetare dhe demokratike. Ai nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e mjaftueshëm të shkollave, teksteve dhe mësuesve të kualifikuar, por sidomos me të drejtën e të gjithëve, ku individët (gra apo burra, vajza apo djem) kanë mundësi të përmirësojnë mirëqenien dhe statusin e vet social - ekonomik dhe të marrin pjesë në jetën publike. Në këtë mënyrë, arsimi ka një cilësi të veçantë: ai u krijon mundësi individëve të sigurojnë një mirëqenie dhe ndarje më të mirë të pushtetit politik dhe ekonomik.

Nevoja për më shumë emancipim të qëllimtë të djemve dhe vajzave të reja është një kampanë e demokracisë, që bie pandërprerë mbi shkollën. Tekstet ekspozojnë fëmijët që nga çështjet lokale deri në ato globale, ku emancipimi i gjithanshëm është përparësi. Shkolla ndikon në strukturën e mendjes së nxënësit, por edhe në atë të mendimit publik. Shumë më tepër se çdo instrument tjetër social e politik, kurrikula sjell në vëmendje të publikut çështje të preferuara prej tij.

Por ajo që na shqetëson është një lidhje e pamohueshme mes pabarazisë gjinore në tekstet shkollore dhe në sektorë të veçantë të tregut të punës. Në arsim kanë ndikime të mëdha çështje si punësimi, ndarja gjinore në punë e profesione, dhe shtresëzimi shoqëror; hendeku gjinor në paga, qëndrimet dhe sjelljet, pjesëmarrja politike dhe mënyrat e jetesës të burrave dhe grave. Fëmijët mësojnë rreth ndarjes gjinore të punës që në shkollë dhe këto njohuri reflektohen më vonë në jetë, kur ata/ato zgjedhin një profesion. Kjo lidhje mund të çojë në një nivel më të lartë të papunësisë ndërmjet grave. Për shembull, vajzat shpesh inkurajohen të studiojnë profesione në fushën e arsimit, shëndetësisë, apo të shërbimeve sociale, që në fakt paguhen më pak dhe kanë një status më të ulët. Dukuri të tilla shkaktojnë një rrezik më të lartë të varfërisë ndërmjet familjeve të drejtuara nga gratë.

Për më tepër, kultura e re për emancipimin gjinor të nxënësve të moshave të ndryshme nuk është lehtësisht e transmetueshme në tekste. Tekstet krijojnë një kulturë të re jo vetëm te fëmijët, por edhe te publiku përmes dritës që hedhin mbi çështje të kapacitetit kulturor gjinor të vetë shoqërisë shqiptare, kuptimit mbi ngjarje dhe ndodhi të së shkuarës dhe të së tashmes. E rëndësishme është që tekstet duhet ta ftojnë fëmijën në dialog.

Në këtë kuadër dija mbi përkatësinë gjinore është më e favorshme t'u vijë nxënësve e trajtësuar në bazë të karakteristikave të moshës së zhvillimit dhe nxënies, duke u trajtësuar si e kuptimtë, e njohur, e dëshiruar, dhe e lakmuar. Publiku i emancipuar është gjithmonë i angazhuar për të kultivuar dhe riformatuar vlerat e tij. Por, kjo kërkon që, rolet gjinore të së përditshmes të zënë vend në tekste vetëm të shoqëruara me ftesa të hapura për debat, që çojnë në ristrukturimin e kapaciteteve të vlerave grupmohës së cilës i adresohet teksti.

Shteti shqiptar politikisht ka një angazhim të mirëartikulluar për edukimin e drejtë të vajzave dhe djemve. E ndërsa ky angazhim shprehet hapur në dokumentet themelore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), edhe paketa Informuese e Alertekstit ka pritshmëri të shprehura hapur për një edukim të drejtë gjinor. Megjithatë, deri tani pak vëmendje i është kushtuar gjetjes së formave që zëvendësojnë ideologjinë e tkurrjes së figurës së vajzës/gruas në role tipikisht femërore, paraqitja e saj si shtojcë e karakteristikave të burrave, si apendiks i jetës sociale. Nga tekstet e reja të përgatitura në kuadrin e reformës së teksteve pritet tejçimi i një ideologjie proaktive në edukimin e të rinjve dhe të rejave.

E rëndësishme është që mesazhet dhe ilustrimet e një teksti që jepen nëpërmjet përbajtjes dhe ilustrimit të projektojnë një vizion të shoqërisë së mundësive të barabarta dhe jo stereotipa gjinore tradicionale. Edhe kur janë pjesë e tekstit, pabarazitë dhe stereotipat gjinorë duhet gjetur mënyra e diskutimit dhe qartësimi të ndikimit të tyre në familje dhe në shoqëri. Nga analiza e teksteve dhe përvojës së deritanishme rezulton një shqetësim, i cili ka të bëjë me rolin që duhet të luajnë tekstet shkollore si instrumente të edukimit të një brezi të ri.

Sistemi arsimor është përçues i kulturës dhe mund të përdoret për të ruajtur gjendjen ekzistuese ose për të përcjellë ndryshim. Në përgjithësi institucionet qendrore në mbajtjen gjallë të pabarazive në shoqëri të luajnë një rol të rëndësishëm në mënjanimin e tyre. Shkolla si institucion, mund të jetë lokomotivë ndryshimi, por së pari duhet të vetë-shndërrohet.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e këtij udhëzuesi

Qëllimi:

Qëllimi i udhëzuesit është të ndihmojë autorët dhe botuesit e teksteve shkollore të kuptojnë dhe të bëjnë të tyren filozofinë dhe metodologjinë e një edukimi gjinor të ekuilibruar,⁶ të gjithëpranuar,⁷ dhe jashtë idoktrinimit gjinor,

⁶ "Edukimi gjinor i ekuilibruar" tenton të evitojë edukimin gjinor preferencial për njërin gjini, krahasuar me tjetrën, dhe synon përfaqësim të ekuilibruar të të dyja gjinive në tekste.

⁷ "Edukim gjinor i gjithëpranuar" edukim gjinor që përcjell përbajtje dhe skema të ndjeshme gjinore.

që vjen nga njëra apo tjetra gjini.

Ky qëllim final, shndërrohet në një realitet të prekshëm, nëse investohet tek të gjithë botuesit duke i mbështetur ata, për të njohur nga afër dhe në detaje tendencat globale, “mëkatet” që përcjellin tekstet e nxënësve përsa i përket edukimit gjinor, kornizat ligjore globale dhe lokale, politikat arsimore dhe dimensionet humane të kurrikulave shkollore.

Objektivat:

- Të lobohet për çështje të edukimit gjinor të ekuilibruar.
- Të ndihmohet në të kuptuarit e nevojës që kanë tekstet e nxënësit, për një ekuilibër gjinor të mjaftueshëm.
- Të ndihmohet për të kuptuar mekanizmat që e bëjnë një tekst të jetë i ekuilibruar nga pikëpamja gjinore.
- Të formatohen standarde për një tekst me ekuilibër gjinor të mirëpritur.
- Të nxiten botuesit të mbështesin ekipet hartuese të teksteve me trajnime specifike për një edukim gjinor të pranuar dhe të ndjeshëm nga perspektiva gjinore.

1.3. *Kujt i drejtohet ky udhëzues?*

Ky udhëzues u drejtohet shtëpive botuese dhe gjithë stafit profesionalo-technik që prodhon një tekst nxënësish. Në mënyrë të tërthortë ky tekst synon të ketë audiencë jo vetëm ata që prodhojnë tekstin, por edhe ekspertët e kurrikulës, ekspertët e politikës arsimore në nivel kombëtar dhe lokal si edhe Bordin Kombëtar të Miratimit të Teksteve. Së fundi, por jo më pak të rëndësishëm, ky udhëzues u drejtohet mësuesve dhe nxënësve, si dy konsumatorët kryesorë të teksteve mësimore.

Në mënyrë të përmbledhur, tre janë ata të cilëve u drejtohet ky udhëzues:

1. **Drejtuesit e shtëpive botuese**, të cilët për nga profesioni dhe përvojat e tyre vetjake mund të mos jenë ekspertë në çështjet e arsimit, por në ato të biznesit, ligjit apo administratës në përgjithësi.
2. **Autorët** që do të hartojnë tekstet e nxënësit, të cilët mund të jenë: profesorë universiteti, ekspertë të fushës (lëndës), ekspertë të arsimit, didaktë, mësues etj.
3. **Stafet mbështetëse**, si: ilustruesit, redaktorët dhe faqosësit, të cilët në dukje janë në periferinë e proceseve, pasi ata konsiderohen si ekspertët e fundit që e marrin tekstin në dorë të përfunduar, por që janë pothuajse të barabartë për nga fuqia vepruese dhe finesat që i japin atij.

Tre auditorët e mësipërm përfaqësojnë profile specifike, krejt të veçanta nga njëri-tjetri. Por fokusi i punës që ata kërkojnë të bëjnë, produkti që duan të prodhojnë dhe përfaqësimi i tyre në “tregun” arsimor është i përbashkët. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë më të detajuar, përgjegjësitë, që duhet të ketë secili nga të sipërpërmendurit re audiencat e sipërpërmendura, në hartimin dhe botimin e teksteve mësimore, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore.

1. Drejtuesit e shtëpive botuese

Drejtuesi/ja i/e shtëpisë botuese përfaqëson një institucion juridik, që me iniciativë vetjake përfshihet në detyrimin për të prodhuar tekste të një cilësie që konkurren në tregun e botimeve dhe që tenton të gjejë konsumatorët, pra nxënësit dhe mësuesit e vet. Cilësia e tekstit në të gjithë parametrat e vet (konceptet e reja, informacioni i ripërpunuar, pyetjet, detyrat, ilustrimet), i bëjnë të mundur të jetë i mirëpritur nga shkolla, nxënësit, mësuesit, prindërit, drejtorët dhe specialistët e sistemit arsimor.

Me këtë status dhe në këtë stad të ri, drejtuesit/es së shtëpisë botuese, automatikisht i lipset të fitojë aftësi të reja, dhe të garantojë një mirëorientim në kërkesat e tregut. Kështu ai do të orientohet më shpejt ndaj prirjeve globale dhe asaj që pritet të ndryshojë nëpërmjet përmirësimit të teksteve mësimore. Kjo kërkesë objektive e garanton një shtëpi botuese të qëndrojnë brenda mundësisë për të konkurruar dhe për të qenë pjesë e tregut të tekstit shkollor.

Detyrimi i drejtuesit/es së shtëpisë botuese fillon që me angazhimin për të kontaktuar me prirjet e reja që vihen re në rajon dhe më gjerë, me standardet e reja që prodhohen nga institucione Europiane për hartimin e teksteve me objektiva globale, të cilat formatohen lidhur me to. Prej këtej lind detyrimi i tyre për të formatuar “kontrata-tip”, me bashkëpunëtorët dhe autorët e teksteve, ku elementët e mëposhtëm duhet të jenë pjesë e kësaj kontrate:

- Afati kohor i hartimit të teksteve, numri i faqeve dhe sasia e ilustrimeve.
- Përbushja e programit dhe detyrimeve që rrjedhin nga kurrikula e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH).
- Cilësia dhe korrektësia e gjuhës amtare standarde.

Detyrimi

Për këtë udhëzues është e rëndësishme që teksti mësimor të jetë në një të ashtuquajtur ekuilibër gjinor. Kjo do të thotë që teksti:

- Të paraqesë jo vetëm atë që është tradicionale;
- Të mos nxisë pabarazi gjinore;

- Të përcjellë edukim gjinor perspektiv (të ndieshëm nga pikëpamja kulturore dhe etnike);
- Të edukojë një qëndrim të ekuilibruar gjinor;
- Të sfidojë stereotipat gjinorë.

Tri detyrimet e sipërpërmendura mund dhe duhet të jenë pjesë e përmbajtjes së kontratës mes drejtuesit/es së shtëpisë botuese dhe ekspertëve të përfshirë në hartimin e tekstit. Në aneksin 1, paraqitet një tip-kontratë midis shtëpive botuese dhe autorit/es së tekstit mësimor. Nga kjo kontratë konstatohet se nuk është parashikuar asnjë çështje, që lidhet me detyrimet e autorit/es përsa i përket ekuilibrave gjinorë. Ajo, në mënyrë të dukshme parashikon afatet, të drejtën e autorit/es dhe botuesit/es, si dhe sistemin e pagesave reciproke. Por, mbeten jashtë përmbajtjes së saj elemente të kontratës, të cilat parashikojnë zbutjen e stereotipave gjinorë.

2. Autorët e teksteve

Autorët e teksteve janë pika kyç që do të përfaqësojnë shtëpinë botuese në tregun e teksteve. Ata prodhojnë tekstin me të gjithë përmbajtjen e vet.

Por, duke qenë personalitete me individualitet krejt të veçantë, me një kapacitet intelektual dhe njerëzor të tyrin, ata sjellin përvoja dhe perspektiva të ndryshme gjinore, duke i dhënë tekstit dimensionet që ata kanë. Për shkak të skemave të tyre të të menduarit dhe të sjellurit, të cilat i kanë marrë përmes modeleve në familje, apo skema të fituara gjatë viteve të shkollimit, ata kanë krijuar dhe projektuar modelet e tyre të femrës dhe të mashkullit. Për rrjedhojë dhe një normë, që përcjell marrëdhëniet mes tyre. Këto skema në tekstet që do të përgatisin dhe në mënyrë të natyrshme i reflektojnë.

Në mënyrë specifike, skemat e tyre të të menduarit dhe të sjelljes, reflektohen në zgjedhjet që bëjnë për tekstet, si:

- ushtrimet matematikore dhe personazhet që zgjedhin të përfshijnë në tekst;
- autorët dhe pjesë leximi, poezi dhe vjersha (autorë femra kujdrejt atyre meshkuj);
- ilustrimet që do të përfshijnë në tekst;
- pyetjet që drejtohen në fund të çdo mësimi si dhe profilet e grave dhe burrave;
- situata problemore dhe marrëdhënie reciprociteti apo vartësie në të cilat hyjnë burrat me gratë dhe anasjellas.

Siç u përmend edhe më sipër, fakti që autorët janë personalitete dhe individualitete të veçanta, me kapacitete unike intelektuale, na çon te nevoja

për t'i kontaktuar ata përpara nënshkrimit të kontratës me shtëpinë botuese, pra përpara fillimit të procesit të përgatitjes së materialit për botim. Kjo bëhet detyrim paraprakisht edhe për të ndarë me ta nevojën për një ekuilibër gjinor të gjithëpranuar të teksteve, si dhe rrugët që garantojnë këtë ekuilibër gjinor brenda një teksti.

Nëse mungon perpjekja për t'i sjellë nëpërmjet tyre tekstet në kontekstin e ekuilibrit gjinor, autorët do të përcjellin parapëlqimet dhe perspektivat personale. Duke krijuar çekuilibër gjinor në tekste, nxënësi/ja edukim gjinor që mund të përballet me probleme në të ardhmen. Nevoja që të gjithë autorët e teksteve të marrin paraprakisht një formim gjinor, dhe të orientohen qëllimshëm tek ato që ekspertët i quajnë “zona në rrezik”, është e kushtëzuar nga fakti që teksti merr detyrime përtej individit. Teksti i nxënësit i shkon një mase kritike qytetarësh në moshë të re, (nxënësish) tek të cilët lipset që informacioni dhe përgjithësisht fryma e tekstit, të shkojë e ekuilibruar.

Është e domosdoshme që autori/ja të ndalet dhe të listojë çekuilibrat gjinorë në një tekst mësimor, duke përcjellë ose parapëlqyer me frekuencë të lartë:

- Imazhin e një gruaje vetëm përkujdesëse, por jo të përfshirë në veprimtari të ndryshme jashtë shtëpisë dhe të një burri të fortë, dhe vendimmarrës, pothuajse jashtë shtëpisë;
- Marrëdhëniet burrë/ grua në forma dhe trajta varësie;
- Imazhin e gruas dhe të vajzës, pa identitet, shpesh pa emër (vogëlushja, bjondja, qukalashja) dhe të djalit me identitet të plotë (syptrembur, trim, i guximshëm);
- T'i drejtohet kryesisht djemve në rubrikën “pyetje dhe detyra” dhe operon me togfjalëshin: “ndani me shokun”;
- Çdo rubrikë të fillojë me një ilustrim, që fokusohet te profili i një mashkulli dhe përjashton atë të një femre;
- Imazhe femërore dhe mashkullore vetëm nga kultura jonë, por jo diçka përtej asaj.

3. Staf mbështetës (ilustruesit, redaktorët dhe faqosësit)

Ilustruesi/ja

Ilustruesi/ja është personi që njeh (duhet dhe mundet) po aq në thellesi misionin e tekstit sa dhe vetë autori/ja e tekstit. Detyra e ilustruesit/es është të pajisë tekstin me vizatime, skica, foto, etj., që e bëjnë më të qartë e më të kuptueshme përmbajtjen e tekstit, një mendim, një çështje, një përfundim, etj. Në këtë kuptim, ilustrimi është dhe konsiderohet nga ekspertët, si pjesë

e rëndësishme dhe integrale, e përmbajtjes së tekstit. Ilustrimi flet dhe përfaqëson po aq përmbajtje, bart po aq mesazhe sa dhe vetë fjala e shkruar në tekst. Jo rrallë, ilustrimi konkuron edhe vetë fjalën, sidomos në tekstet e përgatitura për grupmoshat e vogla.

Shpesh, autorët të gjendur në vakum për të formuluar një ide të sofistikuar, por që trajtat gjuhësore nuk iu vijnë në ndihmë, janë të detyruar të operojnë me ilustrimin. Në këtë kuadër, përzgjedhjen e ilustrimit autori/ja duhet ta bëjë në bashkëpunim të fortë me ilustruesin/en apo piktorin/en. Këta duhet të “blejnë” idenë e autorit/es për të gjetur ilustrimin e duhur, në formatin dhe në ngjyrat e përshtatshme. Ilustrimi nuk aplikohet vetëm për të përmbushur një vakum gjuhësor, por dhe për të përcjellë më shumë ide, më shumë përmasa të idesë dhe më intensitet emocional te nxënësi/ja.

Gjetja dhe përdorimi i ilustrimeve nga autorët gjatë tekstit të nxënësit konsiderohet shumë efikas. Ilustrimi ngacmon përfytyrimin, rrit të menduarit abstrakt, dhe i jep mundësi nxënësit/es, të përcjellë te vetja përmbajtjen e situatës, që bart ilustrimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë jashtë tekstit të shkruar. Mund të ndodhë që teksti i shkruar e keqinformon apo indoktrinon nxënësin/en.

Redaktori/ja shkencor/e

Redaktori/ja shkencor/e është eksperti/ja i/e fundit që merr tekstin në duar. Në këtë kuptim, ai/ajo përfaqëson dhe “traun e doganës” për një tekst të caktuar. Që redaktori/ja shkencor/e të përfaqësojë profesionalisht të gjithë dimensionet e duhura për të miratuar tekstin dhe për t’i hapur udhën drejt përdoruesit, kërkohet të ketë një formim akademik didaktik dhe social të mjaftueshëm. Një përshkrim më i detajuar i rëndësisë së redaktimit shkencor nga pikëpamja gjinore jepet në pjesën e 3-të të këtij udhëzuesi. Aty janë paraqitur “pikat e nxehta” të tërësisë së proceseve që redaktori/ja shkencor/e duhet të kalojë në lupën e tij/saj profesionale.

Faqesësi/ja

Kopertina është një element i rëndësishëm për çdo tekst, duke filluar nga lënda e muzikës apo te matematika, por në mënyrë të veçantë kujdes duhet treguar për tekste, si: historia, leximi, edukata, ku ekziston një frymë e fortë, duke qenë se historinë e kanë bërë të fuqishmit dhe se ata në përgjithësi janë meshkuj.

Ky pohim “heshturazi” i pranuar, nuk mund të përcillet absolutisht kështu. Ka shumë mundësi që kopertina e tekstit të përcjellë një imazh neutral. As imazhin e të “fortit mashkull” as imazhin e gruas në “prapavijë”. Ky parim që mund të funksionojë dhe për tekste të tjera mbetet ende për t’u diskutuar.

II. Edukimi gjinor

Togfjalëshi “edukimi me dhe për përkatësinë gjinore” konsiderohet si parim bazë për çdo ekspert/e që përfshihet në çështje që lidhen me edukimin gjinor.⁸ Nevojën për të përcjellë domethënien e këtij togfjalëshi, autorët e konsiderojnë si pikënisje të çdo materiali të shkruar, apo të një trajtesë të artikulluar, që u drejtohet ekspertëve të edukimit.

Konkretisht, është e rëndësishme që togfjalëshi i mësipërm të ndahet në pjesën e parë “**edukim me**”, i cili duhet të kuptohet si një detyrim i çdo individi që rreket të trajtojë çështje, që lidhen me edukimin gjinor. Së pari, individi duhet të njohë, të besojë dhe të pranojë të jetë ithtar i edukimit gjinor në çdo rrethanë, me çdo auditor, të jetë përcjellës i frymës së edukimit gjinor me mekanizma të natyrshëm, pa u sforcuar dhe pa përdorur moralizime apo indoktrinime.

Pjesa tjetër e togfjalëshit “**edukim për përkatësinë gjinore**” duhet kuptuar si detyrim, që çdo individ ka, për të përcjellë idetë e tij apo të saj dhe frymën e edukimit gjinor tek të tjerët, vetëm pasi ka krijuar brenda vetes dije të thella rreth çështjeve, që lidhen me edukimin gjinor dhe i ka kthyer ato në vlera të edukimit gjinor. Janë pikërisht këto vlera, që i japin atij/asaj të drejtën të jetë përcjellës/e dhe lobues/e, i/e edukimit gjinor.

Të fitosh të drejtën për të përdorur togfjalëshin e lartpërmendur dhe për të përcjellë atë në literaturë apo në auditore profesionistësh, e mjedise publike duhet të jesh i mbarsur mjaftueshëm me idetë dhe çështjet e edukimit gjinor, me përvoja të ndryshme nga kjo fushë, dhe të zotërosh tërësinë e mekanizmave, për t’i përcjellë ato tek të tjerët, cilado qofshin specifikat e tyre.

Edukimi gjinor, ndryshe nga shumë aspekte të tjera të edukimit, nuk ka një standard të paracaktuar dhe nuk matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç mund të maten datat, listat, kategoritë, apo vendet. Pikërisht, prej këtij fakti, edukimi gjinor bëhet një angazhim i veçantë. Ai nuk është edukim feminist, moralizues, me plot artifice, por një ftesë që çdo nxënës/e të ketë shans të mësojë të sillet në përputhje me identitetin e tij/saj gjinor. Paragjykimet në konceptimet dhe parashtrimet e materialeve gjinore gjenden dendur në tekstet shkollore, duke ua pakësuar vlerat e tyre si instrumente të ndriçimit të mendjes dhe emancipimit të shpirtit të nxënësve.

⁸ Togfjalëshi “edukimi me dhe për përkatësinë gjinore” përcjell filozofinë dhe moton e edukimit gjinor. Ky togfjalësh bashkon profesionalizmin me angazhimin në çështjet e edukimit gjinor të personave të përfshirë në këtë çështje.

2.1. Metodologjia

Autorët e teksteve mund të identifikojnë gjithfarë strategjish dhe mundësish për ta bërë tekstin një mjet të dobishëm në edukimin gjinor. Një ndër rrugët më të natyrshme nga ku mund të fillojë prezantimin e drejtë të djemve dhe vajzave çdo tekst, pavarësisht lëndës dhe moshës së nxënësit, është pasqyrimi i jetës në shkollë, një mjedis formal edukimi, por gjerësisht i njohur nga nxënësit. Tekstet mund të portretizojnë jetën e shkollës nëpërmjet veprimtarive të përditshme. Strategjia e sjelljes së djemve dhe vajzave jo vetëm në familje dhe rrugë, por edhe në shkollë, ku marrin apo u caktohen role pavarësisht gjinisë, është një fillim i natyrshëm i edukimit të drejtë gjinor. Portretizimi i djemve dhe vajzave duke u rritur është begati e teksteve. Kështu ndihmohet realizimi i misionit të kurrikulës: t'u mësojë vajzave të zakonshme se për to gjithçka është e mundur.

Autorët e teksteve mund të krijojnë situata nga më problemoret me rolet e djemve dhe vajzave, burrave dhe grave në punët e shkollës. P.sh. një tekst i lëndëve sociale mund të merret me kontributin e gjithkujt për mbarëvajtjen e shkollës. Ai mund të tregojë në funksion të programit, problematikën e saj dhe rolin e vajzave në këshillin e klasës apo të shkollës. Në shkollë ka edhe një bord. Rreth tij, kontributit të nënave dhe baballarëve në të mund të ndërtohen dhjetëra situata problemore për çdo nivel dhe lëndë. Dimensionet shumëplanëshe të meshkujve dhe femrave në shkollë mund të jenë burim nxënieje, zhvillimi dhe qëndrimi androgjinik.

Tekste të fuqishme janë ato që në përputhje me misionin e programit, arrijnë të sjellin për gjykim, analizë, sfidë, paragjykimet e vetë nxënësve dhe mësuesve në mësimin e lëndëve të ndieshme ndaj dallimeve gjinore, si: edukata shoqërore, ajo shëndetësore, biologjia, anatomia, edukata seksuale, etj. Në tekste është normale dhe e dëshirueshme të tregohet përvoja e angazhimit të djemve dhe vajzave në to. Të tilla paraqitje rrisin fuqinë e diskutimeve dhe përfshirjen e vërtetë të djemve dhe vajzave në punët e shkollës. Angazhimi i teksteve qëllimshëm në prezantime të tilla të thjeshta, por të ndjeshme për nxënësit kontribuon në mënjanimin e totalitarizmit mashkullor në shkollë, i cili, pa një aksion të qëllimtë edukativ të të gjithë aktorëve në arsim, do të jetojë përsa kohë pushteti i meshkujve do të mbështetet nga masa e grave në instrumente të largpamësisë si tekstet.

2.2. “Gracka” të deformimit gjinor

Më poshtë përshkruhen konkretisht disa “gracka” të deformimit gjinor, të cilave autorët duhet t'u shmangen.

Objektifikimi i vajzës/gruas dhe pasojat e tij

Trajtat që marrin deformimet gjinore në tekste janë herë-herë lehtësisht të identifikueshme dhe herë - herë tinëzisht të kamufluara. Gruaja është një koncept tërësor. Fatkeqësisht, shpesh kur flitet për të në tekste, zgjidhen dhe bëhen objekt pjesë të veçanta të saj. Për shembull, flitet veçmas për pjesë të sjelljes së saj, paraqiten në ilustrime pjesë të trupit të saj; në situata të veçanta tregohen nga këndvështrimi social, psikologjik, fizik, sjelljes, etj., duke e bërë kështu të vështirë rrokjen e së tërës te gruaja, gjë që përbën vështirësi në kuptimin e thelbit të konceptit të drejtë gjinor dhe edukimit androgjinik.

Rolet e gruas

Paragjykimet dhe stereotipat më të rëndomtë të deformimeve gjinore janë ato ku gruaja identifikohet tërësisht ose kryesisht me funksionet riprodhuese. Të qenit nënë automatikisht i transferon asaj role përkujdesëse përgjatë gjithë jetës. Edukimi gjinor bart edhe çështje të raportit mes gruas dhe burrit. Autorët e teksteve tregojnë kujdes në vendosjen e dy gjinive përballë njëri - tjetrit. Rëndom, këto raporte janë në favor të burrave. Kjo ushqen stereotipa, që prekin jo vetëm burrat dhe gratë, por edhe shumë aspekte të tjera të shoqërisë, përfshirë arsimin, praktikatat e edukimit formal, dhe joformal të brezit të ri.

Për më tepër, edukimi gjinor në tekste cungohet edhe nga paraqitja e ndarë e çështjeve të jetës në “punë/çështje/mendime grash” dhe “punë/çështje/mendime burrash”. Autorët e teksteve të ndjeshme gjinore duhet të kujdesen që figurat femërore dhe mashkullore të tejçojnë një ideologji të drejtë mbi rolet dhe të drejtat sociale. Askujt nuk duhet t’i atribuohen apriori detyra dhe pritshmëri pikërisht pse është mashkull apo femër, burrë apo grua, djalë apo vajzë. Që tekstat të shndërrohen në instrumente tipike zhvillimor, ideologjitë inferiore femërore apo ato prepotente mashkullore duhet t’i lenë vend ideologjisë së të drejtës sociale pa kushte. Autori zgjedh të përçojë atë ideologji që e formon më mirë qytetarin dhe shtetarin e së ardhmes.

Prioritetet familjare

Shoqëria e percepton gruan në funksione dhe role të paracaktuara sociale brenda familjes, madje edhe kur ajo është në karrierë, dikotomia e roleve është një çështje gjithmonë e zgjidhur në favor të familjes. Përparësitë familjare janë madje të lavdërueshme. Edhe kur në tekste vijnë gra të realizuara, ato sillen të mistifikuara, pa jetën e përditshme familjare. Kështu tekstat humbasin

një shans për të qenë më proaktive në zhvillimin dhe emancipimin e vajzave të reja. Sjellja e tërësisë së veprimtarive të grave të suksesshme edhe në familje, edhe në jetë apo karrierë do të jetë një shans për modele imponuese sociale si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Edukimi i grave dhe vajzave është baza e shëndetit, paqes, zhvillimit të vendit dhe demokracisë.

Në tekste ka ilustrime me copëza leximi dhe foto e vizatime, që e portretizojnë gruan në role tipikisht të ndara nga ato të meshkujve. Gratë dalin më dendur të përfshira në trajnime, shkollë, veprimtari edukative, etj., sesa duke kryer punë e duke marrë vendime. A janë vajzat dhe gratë pjesëmarrëse në vendimmarrje? Proporcionalisht me pjesën tjetër të shoqërisë, ato duhet të paraqiten edhe në këto role në tekste.

Tekstet - a krijojnë ndërgjegje morale dhe juridike?

Tekstet, si burim informacioni, përmes shembujve, situatave të rastit, aparatit didaktik që qëllimshëm i drejtohet nxënësit, përpiqen të krijojnë te secili prej tyre një pjesë të ndërgjegjes morale dhe etike nisur dhe nga përkatësia gjinore (kuptimin për veten dhe marrëdhëniet me të tjerët). Në këtë mënyrë, duke kontribuar të ndërtojnë ndërgjegjen etike që buron nga përkatësia gjinore, njëkohësisht, tekstet synojnë të ndërtojnë dhe një dimension “juridik” të ndërgjegjes së nxënësit. Kështu, krijojnë rrethana për t’i dhënë pushtet dhe fuqi arsyetimi, lobimi dhe kundërshtimi nxënësit/es për çështje, të cilat nuk i konsideron se janë të përshtatshme, kur ato lidhen me gjininë dhe socializimin gjinor në tërësi.

Shpesh, tekstet i ofrojnë mundësi për “pushtet” juridik, individit mesatar, filozofisë së tij për jetën dhe rolet sociale. Këtë e bëjnë duke mos sjellë në fokus të përditshmen e grave dhe fuqinë e tyre “juridike” dhe tinëzisht, duke injoruar të drejtën njerëzore të gruas për barazi. “Vrasja” e ndërgjegjes juridike te gruaja që kur ajo është vajzë e re, injorimi i të drejtave të saj për të qenë e barabartë, është hapi i parë drejt dominimit total prej një filozofie mashkullore të nënshtrimit. Nga ana tjetër, ajo që “vret” ndërgjegjen juridike të gruas, “fuqizon” ndërgjegjen juridike të mashkullit.

Përveç kësaj, shpesh, tekstet sjellin realitete mediokre te nxënësit, injorojnë fuqinë e mendjes së tyre, por, po aq edhe të nevojës për rritje të ndërgjegjes morale, e cila buron nga përkatësia gjinore.... “nuk sillet një vajzë kështu”.... “je djalë.... ç’është kjo që bën.....!”.

Prurjet në tekste të rënuara me diversitet, (shembuj) ku spikasin pabarazia sociale e gjinore, bëjnë që nxënësit të humbasin mundësinë për zhvillim të mirëorientuar dhe gjithëpranuar moral për gjykime të argumentuara për të

kuptuar se ç'është mirë dhe ç'është keq në grupin ku jetojnë, por edhe në shoqërinë së cilës i përkasin. “Vrasja” e ndërgjegjes morale, mosdhënia e mundësisë për t'u zhvilluar me norma etike të gjithëpranuara, shpesh, çon te prodhime individësh me inerci sociale, pa ritëm, apati, tërheqje apo sjellje agresive, të pakënaqur dhe depresive. Nxënësit, duhet të ndihmohen përmes teksteve drejt arsytimit, që i nxisin ata të ngrenë skema të ndërgjegjes morale dhe fuqisë juridike. Përndryshe, nxënësit, humbasin mundësinë për të qenë qytetarë të orientuar në shoqërinë e hapur.

Injorimi i gruas në tekste mund të duket edhe si gabim njerëzor, siç shihet në këtë udhëzues. Sjellja e stereotipave të jetës tradicionaliste në tekste duket se është vepër e “fajtorëve pa faj”, kështu do të ishte nëse do të harronim se tekste janë instrumente të zhvillimit social, konjitiv, emocional, moral, politik e ideologjik të brezit të ri dhe autorët arkitektë të qytetarisë së nesërme. Nëse ata do të vazhdojnë të mos e ndiejnë se vëmendja ndaj edukimit gjinor, qytetar dhe demokratik nuk është një çështje preferenciale, por detyrim. Atëherë vajzat dhe gratë do të vijnë të paraqiten si të tepërta, të dorës së dytë, thellë - thellë totalitarizmi do të ndihet mirë. Në shoqëritë totalitare ka një shtresë njerëzish, një elitë që jep mend, që brumëzon jetën, ndërsa të tjerët janë “të tepërt”, “të padenjë”, “të pabesuar”, “të parritur” dhe “të pabarabartë”.

Trajtimi i grave dhe vajzave si “njerëz të tepërt”, jo aq të vlerë, jo aq të barabartë sa burrat dhe djemtë, ushqen totalitarizmin në rastin më të mirë dhe përbën në vetvete një përpjekje totalitare. Dhe tekste tona nuk janë larg këtij shërbimi ndaj totalitarizmit. Njerëzit bëhen të tepërt kur dënimi u jepet edhe kur nuk kanë fare lidhje me krimin. A nuk u japin dënim autorët të pafajshmeve Mirelë, Mimi llasticës, Borë, Entelë duke i paraqitur në tekste si fajtores të dënuara më shumë sesa shokët e tyre Genti, Beni dhe Arditi për të njëjtin gabim?! Edhe Mirela edhe Beni gabojnë. Ndërsa gabimin e Mirelës e merr vesh i gjithë qyteti (“Ja Mirela, thotë kushdo, paska bërë sot një gabim”), për gabimin që ka bërë, Benin e këshillon xhaxhi polici dhe askush nuk e merr vesh.

2.3. Konteksti global dhe edukimi gjinor

2.3.1. Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

Një nga tetë objektivat e mijëvjeçarit të vendosura nga Kombet e Bashkuara në Samitin e Mijëvjeçarit, mbajtur në Nju York në vitin 2000, është “Eliminimi mundësisht deri në vitin 2005, i diferencave gjinore në arsimin fillor e të mesëm dhe deri në vitin 2015 në të gjitha nivelet e arsimit.”

2.3.2. “Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas” (CEDAW)

Edhe ky dokument i ratifikuar nga qeveria shqiptare në vitin 1993 i kushton rëndësi të veçantë barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit të grave dhe vajzave. Duke qenë se është ratifikuar nga qeveria shqiptare, të gjitha nenet e kësaj konvente i bashkëngjiten legjislacionit ekzistues. Në mënyrë specifike, shteti shqiptar, duke qenë se ka ratifikuar këtë dokument - duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mënjeluar diskriminimin e gruas, me qëllim që asaj t'i sigurohen të drejta të barabarta me burrin edhe në fushën e arsimit mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas. Në kuadër të kësaj konvente, ekzistojnë disa kushte apo detyrime, që shteti shqiptar duhet të ofrojë.

2.3.3. “Konferenca e Pekinit” dhe “Platforma për Veprim”

“Konferenca e Katërt Botërore e Grave” në Pekin, 1995, dhe “Platforma për Veprim”, e mbështetur nga 180 vende, u fokusua në parimet universale të drejtësisë gjinore. Platforma për Veprim e Pekinit përfshin ***një seksion të veçantë për arsimin dhe trajnimin e grave dhe vajzave***. Objektivat strategjike të identifikuar në këtë seksion janë: sigurimi i mundësive të barabarta për t'u arsimuar; zhdukja e analfabetizmit në radhët e grave; përmirësimi i mundësive të grave për të marrë trajnime për të shfrytëzuar shkencën e teknologjinë dhe arsimin e vazhdueshëm; zhvillimi i një arsimit dhe kualifikimi jodiskriminues; shpërndarje e burimeve të mjaftueshme mbi dhe për monitorimin e zbatimit të reformave në arsim; promovimi i një arsimit afatgjatë si dhe kualifikimi i grave dhe vajzave.

Duke pranuar se arsimi jodiskriminues kontribuon në marrëdhënie më të barabarta midis grave dhe burrave “Platforma për Veprim” identifikon dhe fushat në të cilat ekziston një arsim i tillë diskriminues, duke përfshirë: qëndrimet tradicionale; martesat dhe shtatzënitë e hershme; mungesa e ndërgjegjësimit gjinor në sektorin e arsimit; përgjegjësitë shtëpiake të vajzave dhe koha e pakët që ato kanë në dispozicion për t'u arsimuar dhe ngacmimi seksual.

Përsa i përket diskriminimit në arsim, ai është i pranishëm në: mësimdhënien e dhe materialet papërshtatshme, bazuar në paragjykimin gjinor; mungesën e lehtësirave për t'u arsimuar, në veçanti në përshtatje me nevojat e vajzave; imazhet e stereotipizuara të grave dhe burrave në materialet dhe mësimdhënien në arsim; programet me paragjykim gjinor dhe materiale mësimore, që përforcojnë rolet tradicionale seksuale; programet dhe tekstat shkencore që bartin paragjykim gjinor; burimet e pamjaftueshme të arsimit, sidomos për gratë dhe vajzat.

“Platforma për Veprim” rekomandon strategji specifike për secilin prej

faktorëve të mësipërm dhe përkrah përdorimin e rrugëve për ndryshim, të tilla si shfrytëzimi i plotë i potencialit edukues të medias, duke synuar përfshirjen e grave në zhvillimet teknologjike në fushën e arsimit.

2.3.4. Konferenca e Kombeve të Bashkuara Pekin + 10

Në Pekin +10, një dekadë pas Deklaratës së Pekinit, u rishikua dhe u vlerësua periudha dhjetëvjeçare e zbatimit të “Platformës për Veprim”. Në këtë takim, në fjalën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e përqendroi vëmendjen te shtatë prioritetet e propozuara nga rekomandimet e OZHM-ve për barazinë gjinore, ku objektivi i 7-të i referohet arsimit: *“Zgjerimi i mundësive të edukimit të vajzave në sistemin fillor dhe atë të mesëm”*.

2.4. Konteksti kombëtar dhe edukimi gjinor

“Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare.”
(Ligji *“Për Arsimin Parauniversitar”*).

2.4.1. Kushtetuta e Shqipërisë

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë çdo njeri ka të drejtën për t'u arsimuar. Arsimi tetëvjeçar dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas (neni 57 i Kushtetutës). Në nenin 18 të Kushtetutës përcaktohet se *“të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”*.

2.4.2. Ligji për Arsimin Parauniversitar

Në ligjin *“Për Arsimin Parauniversitar”* Nr.7952 datë 21.06.1995, shprehimisht thuhet: *“Arsimi realizohet në përputhje me parimet e sanksionuara në legjisllacionin në fuqi, mbështetet në traditat dhe arritjet e shkollës sonë kombëtare dhe kryhet në përputhje me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”*

2.4.3. Ligji *“Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë”*

Ligji *“Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë”* i miratuar në korrik 2004 nga Kuvendi i Shqipërisë, që synon të plotësojë kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta për burrin dhe gruan. Ky ligj konsiston në vendosjen e të dyja sekseve në pozita të barabarta në fushën e arsimit, punësimit, dhe vendimmarrjes.

Ligji parashikon ngritjen e mekanizmave qeveritare për hartimin e politikave qeveritare për barazinë gjinore, vlerësimin dhe monitorimin e situatës konkrete. Ky ligj, gjithashtu, adreson çështjen e diferencave gjinore në fushën e arsimit. Në nenin 8 të këtij ligji “Veprimet Diskriminuese në Institucionet e Arsimit dhe Shkencës”, theksohet: *Veprimet e institucioneve arsimore dhe shkencore do të konsiderohen diskriminuese nëse, duke u mbështetur në seksin, zbatohen kërkesa të ndryshme përkatëse ndaj burrit dhe gruas për pranimin në shkollë ose për programet e studimit, për hartimin e kurrikulave ose për vlerësimin e njohurive; krijohen mundësi të ndryshme për zgjedhjen e një fushe të veçantë studimi, trajnimi, diplomimi dhe për kohëzgjatjen e mësimi.*

2.4.4. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Pjesa e Arsimit

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (2007-2010) ka si qëllim përmirësimin e rezultateve me bazë gjinore në sistemin arsimor të Shqipërisë. Më poshtë paraqiten rekomandimet konkrete të kësaj strategjie lidhur me integrimin gjinor në arsim:

1. Përmirësimi i programeve shkollore që nxitin barazinë gjinore si dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mësimdhënie, planifikimin dhe menaxhimin e arsimit.
2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore për të integruar çështjet dhe konceptet e barazisë gjinore në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin në arsim.
3. Përmirësimi i qëndrimeve shoqërore dhe kulturore të komuniteteve dhe familjeve, që nxitin vlerat dhe rëndësinë e arsimit të vajzave, duke përfshirë rolet dhe kontributet e grave dhe vajzave në zhvillim.⁹

2.5. Apeli për zhvillim të dimensionit gjinor në tekste

Apeli për përkushtim ndaj çështjes gjinore nuk shtrohet si kërkesë kalimtare, meqë bota ia ka kushtuar dekadat e fundit përpunimit të mendimit të drejtë gjinor dhe çështjeve të ndërtimit të një shoqërie me të drejta dhe me mundësi të barabarta si për djemtë, ashtu edhe për vajzat. Këto janë arsye të mjaftueshme politike, por krahas tyre ka edhe një thirrje të brendshme për ndihmë nga tekstet. Nga analiza e teksteve të shkollës fillore në drejtim të angazhimit të tyre në edukimin gjinor, u vu re një rastësi groteske e hiperbolizimit të roleve mashkullore dhe nënçmimit të atyre femërore. Tekstet e frikësojnë vajzën dhe fuqinë e saj për t’u rritur si qenie e lirë në një shoqëri të individëve të lirë. Qëllimi i tekstit është të rrisë repertorin e shprehive të interpretimit të përvojës njerëzore (burrave dhe grave) si dhe të krijimit të aftësisë për të marrë vendime gjinore të informuara.

⁹ Botimi i MPÇSSHB, 2008: 44 - 45.

Si përfundim, në disa raste legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për arsimimin e grave. Për shembull, Kushtetuta shpall arsimimin e grave në vështirësi ekonomike dhe sociale si një nga objektivat sociale të Shqipërisë. Kategoritë e personave që përfitojnë nga Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional përfshijnë vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuar dhe gratë e divorcuara me probleme sociale (VKM Nr. 616, 4 Dhjetor 2002, marrë nga raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës CEDAW në Shqipëri). Në këtë kontekst, arsimi në të gjithë përbërësit e vet, pra dhe në "tekstin e nxënësve", duhet të përmbushë detyra të emancipimit shpirtëror dhe zhvillimit social të individit. Tre nenet e para të ligjit krijojnë mjaftueshëm mundësi dhe hapësira për t'u fokusuar te çështjet e përkatësisë gjinore. Ligji për arsimin parauniversitar nuk mbart "mëkatin" e ndalimit të iniciativave dhe i krijon hapësirë kujdesit për çështjet e përkatësisë gjinore (Analiza Gjinore e Teksteve të Shkollore Filllore, QAGJZH, 2005).

III. Tekstet mësimore në këndvështrimin gjinor

Në fund të studimit “Analiza gjinore e teksteve të shkollës fillore” (2005) është mbërritur në disa përfundime, më kryesoret e të cilave janë si më poshtë:

- Në tekstet e ciklit fillor ekzistojnë inkoherenca mes dokumenteve bazë që rregullojnë politikat arsimore. Është e nevojshme të ketë më tepër koherencë midis hapësirave, që krijon ligji për arsimin parauniversitar në nenet 1, 2, 3, dhe standardeve të përmbajtjes, programeve lëndore, për të shkuar tek tekstet e nxënësit/es, të cilat përcjellin idetë dhe mesazhet e dokumenteve të mësipërm;
- Standardet e përmbajtjes dhe programet lëndore nuk përmbushin qëllimshëm objektivat gjinore që kërkohen në mijëvjeçarin e ri;
- Dukshëm, tekstet paraqesin role gjinore të stereopitizuara dhe herë-herë tradicionale apo arkaike;
- Autorët e teksteve nuk kanë marrë në konsideratë rëndësinë që ka androgjinia në prezantimin e çështjeve gjinore;
- Personazhet e përfshira në tekste, sidomos ato të teksteve të leximit, dominohen nga figura tipike të meshkujve dhe përcjellin sjellje tipike mashkullore;
- Personazhet e sjella në tekste, përcjellin sjellje tipike (tradicionale) femërore apo tipike mashkullore;
- Imazhet e femrës në tekste përcillen më shumë në rolet e përkujdesjes dhe të kujdestarisë, sesa të kërkuesit, vendimmarrësit dhe të lidershit;
- Tekstet nuk ruajnë një ekuilibër mes profesioneve tradicionale dhe atyre të reja dhe nuk kujdesen për te balancime gjinore në profesione;
- Liderhipi në të gjitha aspektet e jetës së individit, me përjashtim të atij të jetës familjare, i besohet meshkujve ndërkaq edhe kur shfaqen, janë në një sfond të zbehtë;
- Burimet prej nga vjen autoriteti gjinor në tekste gjendet në familje, aty ku dhe rolet janë përgjithësisht të ngurtësuara dhe tradicionale. Tekstet ndalen te nëna, babai, vëllai, motra më shumë sesa te gruaja, burri, djali, vajza, lideri, liderja;
- Skena tipike ku formohen rolet gjinore mbeten ato familjare dhe më pak ato në shkollë dhe pothuaj fare pak në komunitet (përjashto rastin e edukatës qytetare);
- Ilustrimet e teksteve lënë shumë për të dëshiruar, jo vetëm në pikëpamjen e cilësisë, por dhe të rolit që luajnë në formimin gjinor. Ato përcjellin numerikisht më shumë figurën e gjinisë mashkullore dhe në role inicuese, kërkimore dhe vendimmarrëse;

- Aparati i të pyeturit në fund të çdo njësie mësimore duket se ka qenë jashtë vëmendjes së autorëve të tekstit. Pyetjet rastësisht qëllojnë të jenë gjithëpërfshirëse apo përjashtuese. Kjo ka bërë që shumë pyetje t'u heqin mundësinë për t'u përgjigjur gjinive respektive.

Duke pranuar që tekstet shkollore janë një mjet i fuqishëm informimi, edukimi dhe zhvillimi, me një kontribut gjigand civilizues të faktorit gjinor, mbërrimë në përfundimin se ka nevojë për më shumë vëmendje të qëllimshme në këtë pikë. Manipulimi së jashtmi i mënyrës së ndikimit të përkatësisë gjinore të fëmija është i vështirë, por i mundur. Instrumentalizimi i kurrikulës duhet të jetë strategji e edukimit gjinor. Tekstet në vetvete janë instrumente të të nxënësve, por jo qëllimi i fundmë i tij. Rolet gjinore të sjella në tekste nuk janë dije përfundimtare. Nuk mund të pritet që fëmijët t'i mësojnë rolet siç paraqiten në tekste. Në fakt, teksti vetëm të ndihmon me teknikën e arsytimit për rolet gjinore.

Në të vërtetë, mungesat e konstatuara në prezantimin e roleve të balancuara gjinore, nuk përbëjnë mëkat të autorëve të teksteve të shkollës fillore, pasi ndjeshmëria për çështje të përkatësisë gjinore, nuk ka qenë pjesë e kontratës së autorëve të teksteve. Edhe në rastet kur tekstet do të pasqyronin ndjeshmëri gjinore, përsëri shkolla si institucion vlen të nxisë praktika për zbatimin e materialeve kroskurrikulare dhe ekstrakurrikulare.

Duhet pranuar se ka dy tendenca në formimin e identitetit gjinor:

Së pari: ndryshimi i vazhdueshëm i roleve gjinore në secilin institucion social;
Së dyti: konservimi i roleve gjinore tradicionale.

Tekstet aktuale zgjedhin për t'u prezantuar nxënësve modele më të hasura të roleve gjinore tradicionale të ruajtura në familje. Besohet se tekstet e përmirësuara qëllimisht në favor të modeleve të avancuara socialo-gjinore, që gjenden dendur në shoqërinë shqiptare, do të përshpejtojnë shoqërizimin gjinor dhe do të favorizojnë zgjidhjen e krizës së identitetit gjinor.

Për një zbatues të kujdesshëm të ligjit, përfshirë edhe hartuesit e teksteve, nga përmbajtja e neneve 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, rrjedhin detyrime që duhen sanksionuar në standarde dhe programe. Në rastin konkret, vërehet inkoherencë mes ligjit, standardit dhe programeve të shkollës fillore.

Misioni i shkollës parë në dritën e ligjit, i vë hartuesit e standardeve dhe programeve, para detyrimit për të formuluar jo vetëm objektiva të mirëfillta për lëndën, një grup konceptesh specifike të lëndës, por dhe një listë konceptesh, dhe praktikash, që lidhen me formimin e nxënësve si qytetar. E thënë në mënyrë specifike, duhen formuluar objektiva për edukim gjinor, si edhe politika trajnuese që mësuesit të aplikojnë mësimdhënien, duke patur parasysh edhe çështjet e përkatësisë gjinore.

Programet mësimore mund të pasurohen me objektiva që e orientojnë hartuesin e tekstit të nxënësit/es dhe mësuesin/en të kthejnë vëmendjen te roli i individit në jetën shoqërore. Përveç kësaj, edhe programet kombëtare trajnuese për mësuesit duhet të orientoohen dhe të fokusohen në objektin e çështjeve të përkatësisë gjinore”.

3.1. Sjellja dhe stereotipat gjinorë në tekstet e analizuara

Me kalimin e kohës shoqëria ka stereotipizuar sjelljet për djemtë dhe për vajzat, duke kërkuar prej tyre sjellje tipike. Kjo ka vënë në pozicione disi privilegjuese djemtë, ndërsa më pak vajzat. Duket se sjelljet stereotipike janë të pashmangshme, duke ia atribuuar ato aspektit fiziologjik të secilës gjini.

Nga analiza që u është bërë teksteve të nxënësve të shkollës fillore me synim edukimin gjinor dhe analizën e teksteve të shkollës së mesme me qëllim edukimin me shprehitë për jetën, ka rezultuar se çështjet që lidhen me edukimin gjinor në përgjithësi, nuk vijnë në ekuilibrat e duhur. E thënë ndryshe, edukimi gjinor vjen i stereotipizuar dhe rolet sociale për gjinitë respektive, jo rrallë deformohen. Shpesh, ndodh që tekstet e nxënësve dhe realiteti i përditshëm, servirin realitete krejt të ndryshme, janë larg njërit-tjetrit dhe jo në përmbushje të tyre. Kjo është aq e dukshme sa lind nevoja të kontrollohet viti i botimit, pasi krijohet përshtypja sikur autorët i drejtohen një nxënësi/eje në një kohë dhe vend tjetër. Jo rallë tekstet përcjellin dhe përforcojnë modele tipike të sjelljes tradicionale gjinore (Dhamo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti, 2005).

Paraqitja e gruas/vajzës në role tradicionale

Një nga format e çekuilibrit gjinor në tekste, është prirja për të paraqitur gratë/ vajzat në role të stereotipizuara, tradicionale, në formate të “ngrira”. Autorët parapëlqejnë të paraqesin nënat brenda shtëpisë, duke u kujdesur për pastërtinë dhe ushqimin, për fëmijët e sëmurë, etj., ndërsa baballarët jashtë, në punë, në vendimmarrje, në drejtim, në ceremoni suksesi etj. Vajzat paraqiten në tekste në role përkujdesjeje si brenda, ashtu dhe jashtë shtëpisë, ndërsa djemtë janë në role më aktive, më të angazhuar me sporte dhe aktivitete drejtimi apo udhëheqjeje.

Kjo do të thotë se në këtë tekst gruaja vjen vetëm në nivel horizontal, imazhi i saj nuk rritet, atë nuk e shikojmë përtej familjes dhe në detyra të reja. Te nxënësit kemi përcjellë idenë se ky është pozicioni më i natyrshëm i gruas dhe i nënës. Imazhet e përsëritura e pajisin nxënëin/en me ide të qëndrueshme dhe krijojnë tek ai/ajo skema të menduari që me kalimin e kohës ngurtësohen.

Kanalizimi i të menduarit të nxënësve

Ndonjëherë, çekuilibri gjinor është edhe më tinëzar. Ai paraqitet i fshehtë, me një linjë më të gjatë prezantimi. Kështu, p.sh., në tekstet e matematikës djemtë dhe baballarët kanë para, dhe psonisin e blejnë. Ky është një skenar i përsëritur, me një frekuencë të lartë. Po ashtu, ata përfshihen në veprimtari të ndara në meshkuj, dhe femra, djemtë paraqiten më të suksesshëm sesa vajzat në formulimin e problemave gjejmë artikulime, si: djemtë hapën më shumë gropa se vajzat, djemtë bënë më shumë flamuj etj. Për klasa më të rritura, në tekste shkenca paraqitet dukshëm si atribut i meshkujve. Kontributet më të mëdha në shkencë i kanë bërë meshkujt. Edhe në lëndën e historisë, e cila priret të paraqesë dimensionin e luftës dhe të vendimeve politike, ku në qendër del imazhi mashkullor. Autorët nuk eksplorojnë të identifikojnë imazhe femërore që kanë kontribute në aspekte të tjera të historisë, si: historia e arsimit, shkencës, kulturës etj.

Nëse konceptimi për historinë do të jete më dimensional dhe jo vetëm si histori e luftës dhe paqes, por dhe si histori e kulturës, arsimit, dhe lëvizjeve, ka shume shanse të vijë në faqet e tekstit imazhi i gruas. Këto paraqitje shfaqen tinëzisht në tekst, dhe po tinëzisht depërtojnë te nxënësi, duke formuar tek ai/ajo pritshmëri të tilla, si: “historia është vendi ku luajnë meshkujt”, “shkenca është për djem”, “përkujdesja për gruan dhe vajzat”, duke krijuar te nxënësit skema të ngurtësuar dhe tradicionaliste për gruan dhe burrin, vajzat dhe djemtë.

Përgjithësisht në tekste, vajzat përfaqësojnë rregullin, kujdesin, vëmendjen ndaj më të vegjëlve, të moshuarve e pastërtisë, ndërsa djemtë gjenden disi jashtë kësaj përgjegjësie. Por, në sensin cilësor, ndryshimet janë të mëdha. Ajo që bie në sy është stereotipizimi i roleve: “*mësueset janë femra*” (por vetëm kur nxënësit duhet të mësojnë rregullat e semaforit, vetëm atëherë del në skenë një mësues mashkull) dhe “*sportistët janë meshkuj*”, në “*restorant gatuan mashkulli*”, “*në familje nëna ose gjyshja*” ndërsa “*gjyshi tregon përralla*”, “*këshillon fëmijët për jetën*”, nëna - femra “*pret mysafirë në shtëpi*”, mashkulli “*është në juri, gjykon*”, femra “*thur triko, mjet lopën*”, mashkulli “*nget biçikletën*”, “*drejton mbledhjen*”, “*drejton autokombajnën*”, “*punon tokën*”, “*këshillon gjatë punës*”, femra “*respekton rregullat e qarkullimit rrugor*”, “*ecën me kujdes*”, mashkulli “*i thyen rregullat*”. Femra “*pret me gërshtë*”, “*ka dëshirë të ketë shtëpi dhe piano për kukullën*”, “*fshin shtëpinë*”, “*qëndis lule*” (role brenda shtëpisë), mashkulli “*pi çaj*”, “*zë peshk*”, “*ëndërron të ketë balonë*” (role jashtë shtëpisë).

Stereotipat gjinore kanë efekt negativ mbi individin. Ata prekin konceptin për veten, shëndetin mendor dhe emocional të njeriut dhe reflektohen në sjellje. Ndryshimet në konceptin mbi veten, të kombinuara me stereotipa

të tjerë, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sjellje: femra me tipizim gjinor femëror vepron jo mirë në situata dhe veprimtari “mashkullor”, që kërkojnë konkurrencë, pavarësi; meshkujt e tipizuar në rolin mashkullor veprojnë dobët në situata, që kërkojnë empati, përkujdesje ose shprehje të ndjenjave. Sjelljet e shndërruara duket se shërbejnë edhe si justifikime për ndarjen e roleve të meshkujve, dhe femrave gjatë karrierës së tyre.

3.1.2. Stereotipizimi gjinor

Përfshin perceptimet e shoqërisë dhe sistemet e vlerave, të cilat ndikojnë në krijimin e një imazhi të gruas si krijesë e dobët, e varur, e nënshtruar, e pavendosur, emocionale dhe pasive. Burrat, nga ana tjetër, janë të fortë, të pavarur, të plotfuqishëm, dominantë, të vendosur dhe logjikë. Janë imazhe, ide apo besime të pavërtetuara, të lidhura me një grup të veçantë dhe të fiksuar në mendjen e një njeriu; ato nuk janë të hapura për ndryshime. Për shembull, rolet e grave, funksionet dhe aftësitë shihen si parësore brenda mureve të shtëpisë. Procesi specifik i socializimit, i cili u mëson njerëzve rolet gjinore, quhet **gjinizim** ose **indoktrinim gjinor** (Bhasin, 2006). Ky përçohet nga institucionet, legjislacioni, tekstet shkollore etj. Janë mekanizma të ndryshëm shoqërorë ata që u mësojnë fëmijëve mashkulloren dhe femëroren e personalitetit dhe i bëjnë ata të **brendësojnë** sjelljen, qëndrimet dhe rolet.

Koncepti për veten si njeri, profesionist, i papunë, prind, fëmijë, grua, apo burrë dhe roli që luajmë në jetë, ndërtohet dhe formohet nga shoqëria. Te njeriu formohen qëndrime dhe shprehje të caktuara, që nxitin sjellje të qëndrueshme dhe role të ndryshme tek individë të veçantë. Kështu, sapo fëmija lind, të rriturit që e rrethojnë, bëjnë dallimin e parë të tij: djalë apo vajzë. Ky dallim do ta shoqërojë foshnjën gjatë gjithë jetës së tij/saj.

Në kontekstin e zhvillimit, e drejta për të përfituar shërbime, produkte dhe komoditete të ndryshme. Në kontekstin e “Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave”, aksesit ndaj burimeve dhe shërbimeve është një objektivi i barazisë gjinore, ndërkohë që mobilizimi i grave për të arritur atë që është një element i fuqizimit të grave.

Janë pikërisht rolet dhe stereotipat gjinorë për gratë dhe burrat, që ndikojnë në të gjitha aspektet e funksionimit individual e ndërpersonal, por dhe në pozicionin e tyre në shoqëri. Mënyra sesi familja dhe shoqëria i socializon individët, krijon nxitjen e nevojshme për të zhvilluar aftësi dhe shprehje të ndryshme. Vajzat, në përgjithësi, nxiten të kenë aftësi edukuese dhe përkujdesëse, ndërsa djemtë aftësi konkurruese, dhe shprehje të sigurimit të të ardhurave. Në këtë mënyrë gratë dhe burrat përgatiten të përmbushin pritshmërinë, që ka shoqëria për secilin prej tyre. Në përgjithësi, *kur hyjnë në tregun e punës, gratë dhe vajzat pritet*

të kenë profesione më humane të tilla, si: mësuese, edukatore, infermiere, sociologe, punonjëse sociale etj., të cilat konsiderohen edhe si vazhdim i rolit riprodhues social, që gratë luajnë kryesisht në familje.

Bazuar pikërisht në këta stereotipa gjinorë të pasaktë, mesazhe të padukshme dhe të paqëllimshme mund të krijojnë idenë mes vajzave dhe djemve se ka fusha në të cilat nuk mund të jenë të suksesshëm/suksesshme për shkak të gjinisë së tyre. Materialet shkollore që kanë paragjykime gjinore në gjuhën, përmbajtjen dhe në ilustrimet, përforcojnë idenë se disa fusha janë shumë specifike, sa i përket qenies femër apo mashkull. Kjo ndarje vihet re në tekstet shkollore përforcohet jo vetëm nga ndarja gjinore e punës brenda familjes, por edhe nga komuniteti në të cilin jetojnë si dhe nga rolet e profesionet, që media përçon përmes imazheve dhe mesazheve të saj.

Përgjithësisht, në tekstet shkollore të analizuar, nënat dhe baballarët shfaqen në profesione të ndryshme. Ajo që të bën përshtypje është fakti se burrat dhe djemtë shihen në një sërë profesioneve që në përgjithësi kanë status, reputacion dhe pagë më të lartë. Ndërsa profesionet në të cilat prezantohen gratë dhe vajzat, në përgjithësi janë më të kufizuara, në status dhe reputacion, si rrjedhojë, pagesë më të ulët.

Në këto tekste, profesionet "tipike mashkullore" janë ato të minatorit, sportistit, policit të trafikut, postierit, mjekut, aviatorit, dirigjentit, piktorit, hidraulikut, këpucarit, muratorit, projektuesit, astronautit, kapitenit të anijes, shoferit, punonjësit të zjarrfikëseve, mjekut, menaxherit, ushtarit, etj. Nga ana tjetër, profesionet në të cilat paraqiten gratë dhe vajzat janë ato të mësueses, sekretares, këngëtares, infermieres, shitëses, balerinës, bibliotekares, dentistes, mami, laborantes, sanitares edhe ndonjëherë e punonjëses së policisë së trafikut që shfaqet e frikësuar prej tij.

Është e rëndësishme të citohen edhe **modelet pozitive** të paraqitura në tekstet shkollore të analizuar. Kështu, në disa nga ilustrimet e analizuar, paraqiten djem dhe vajza në kinema; një vajzë që lexon; një vajzë që pikturon; një vajzë që sheh televizor; një vajzë që punon në kompjuter; një që luan tenis dhe një që noton.

Çdo shoqëri është e përgatitur të shikojë individët **me përkatësi dhe identitete të ndryshme gjinore** në profesione relativisht të mirëpërcaktuara, brenda etnopsikologjisë së tyre. Për shumë shoqëri ekziston një ndarje "tradicionale" e profesioneve nisur nga përkatësia gjinore, por jo nga **identiteti gjinor**. Zhvillimi i shoqërisë së hapur dhe evoluimi i teknologjisë ka prekur dhe shmangur ndieshëm kuptimet tradicionale për profesionet nisur nga **identiteti gjinor**. Kështu, gjithnjë e më pak profesionet janë të kufizuara nga përkatësia gjinore (Dhamo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti, 2005).

Si përfundim, roli pasiv i grave haset shpesh në tekstet e analizuar. Modeli i paraqitur për gratë është kryesisht i grave shtëpiake të varura ekonomisht, duke krijuar idenë se vajzat, që shohin këto modele nuk mund të jenë gjë tjetër veçse shtëpiake të ardhshme. Me përjashtim të grave mësuese, ato janë paraqitur në situata brenda shtëpisë, me fëmijët dhe në dyqane duke blerë. Ndërsa burrat janë prezantohen në një rang të gjerë profesionesh dhe të një niveli të lartë në krahasim me ato të grave.

3.1.3. Lidershipi

Shembujt nga historia e shoqërisë njerëzore tregojnë se personazhet përfaqësuese vijnë kryesisht nga meshkujt dhe relativisht më pak nga femrat. Lidershipi në jetën e shoqërisë në përgjithësi dhe në jetën e secilit institucion social, në veçanti i besohet më shumë individëve me përkatësi gjinore mashkull sesa femër. Për pasojë, jemi mësuar të shikojmë kryesisht lider meshkuj, që udhëheqin aspekte të ndryshme të jetës shoqërore dhe shpirtërore.

Edhe në raportet me të tjerët, mbizotërimi sasior është në favor të gjinisë mashkullore. Djemtë janë më shpesh të përfaqësuar në takime të ndryshme. Madje edhe takimet e tyre shpesh nuk janë rastësore. Në këtë kontekst, djemtë zgjedhin djemtë, ashtu si edhe vajzat zgjedhin vajzat. Djemtë janë më të gatshëm të flasin me të rriturit (piktorin, mësuesin, madje dhe me të huaj), ndërsa vajzat nuk dalin në skenë. Vajzat urohen me telefon për vitin e ri, ndërsa djemtë i gjen së bashku me kapele në kokë, duke rregulluar pemën e Vitit të Ri.

3.1.4. Skena tipike të formimit të roleve gjinore

Skena tipike e natyrshme e formimit të roleve gjinore të nxënësit e shkollave të mesme është mikromjedisi social pranë familjes. Paraqitja në tekstet shkollore e kësaj moshe, mjedisit dhe detyrave familjare bie ndesh me skenën për të cilën ka nevojë fëmija ta ketë model. Tekstet vijojnë t'i japin nxënësit mesazhin të kthehet në skenën familjare.

Nxënësit i ndjekin rolet gjinore në kontekstet e pjesëve të dhëna. Ata janë robër të teknikës së autorëve për të përqsaur role në kontekste të arritshme konjitivisht nga fëmijët. Në tekstin e gjuhës shqipe *“Skënderbeu ishte trim. Ai kishte një shpatë të madhe. Por, Skënderbeu kish edhe një shpatë të vogël dhe të drejtë!”* Në tekstin e historisë ai paraqitet hero i rrallë. Po as skenat e Skënderbeut, dhe as skenat familjare nuk shkojnë konform kërkesave për zhvillim normal të strukturës sociale të fëmijës. Këto skena të tejshkuara në vlerë ose të largëta e pa kuptim, injorojnë nevojat e nxënësve për modele normale.

3.1.5. Autoriteti gjinor

Autoriteti është një nga mekanizmat e formimit të *identitetit gjinor*. Në tekste vërehet një frekuencë e dendur e autoritetit femëror dhe një frekuencë e rrallë, po e fortë, e autoritetit mashkullor. Autoriteti gjinor ushtrohet në mënyra të ndryshme. Nëna mbetet burim i fuqishëm “Mos-i” për fëmijët. Morali i nënës kërkon të bëhet dominant, duke i dhënë fëmijës mesazhin e stërlashtë biblik mbi rolin e mashkullit: të jetë përgjegjës, i fortë, se do t’i duhet ta sigurojë jetën me mundim.

Duket se gratë nuk mund ta mbrojnë veten. Në tekstin e historisë përmenden pa fund ngjarje dhe bëma burrash e djemsh në pozicione mbretërishe, princërishe, udhëheqësish, presidentësh, kryetarë shtetesh, shkrimtarë, historianë e poetë. Mes tyre përmenden vetëm emrat e disa grave dhe vajzave, që mund të numërohen me gishtat e njëjës dorë. Në faqen e parë të tekstit Historia e klasës 4 qëndron një grua me rroba popullore dhe një poçe, simbol i ushqimit dhe rolit mbështetës të femrës. Në përfundim të tekstit gjendet një mësim për Nënë Terezën, simbolin e arritjes dhe të shenjtërisë së femrës shqiptare. Pjesa tjetër e librit është histori e meshkujve. Ky çbalancim në prezantimin e figurës femërore në histori çon në pritshmëri më të ulëta për rolin e femrës dhe në pritshmëri më të larta ndaj meshkujve për fatet e të tjerëve.

Tekstet e gjuhës dhe historisë mashkullit i atribuojnë më shumë mundësi vendimmarrje se sa femrave. Në mjediset e reja sociale ku fëmija, sipas Erikson, formon personalitetin e tij, duket se më aktivët në vendimmarrje janë meshkujt. Ata shpesh dalin më të ngarkuar drejtpërdrejtë me barrën e përgjegjësisë. Nxënësit presin të shikojnë të tjera modele sjelljesh të mbështetura më fort në arsye (Dhamo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti, 2005).

3.1.6. Mbizotërimi gjinor i roleve sociale

Individi, pavarësisht nga përkatësia gjinore, kryen disa role në institucionet sociale që mund të kenë interpretim gjinor. Familja është institucioni social disi më "konservator" se institucionet e tjera, në kuptimin se aty ndryshimi mund të ndodhë më ngadalë. Edhe rolet gjinore të individit në familje janë përgjithësisht tradicionale. Nuk ndodh kështu në institucionet sociale të tjera, si: shkolla, komuniteti etj., ku individi luan role sociale pavarësisht përkatësisë së tij gjinore.

Në rolet që u vishen, djemtë paraqiten si shumë aktivë, ndërkohë që vajzat paraqiten në role ndihmuese dhe mbështetëse; ato nuk marrin iniciativa. Në Diturinë e Natyrës 3:95, në foto jepet një vajzë dhe një djalë, të cilët po

mbjellin një pemë të vogël. Djali mban një lopatë dhe përgatit tokën, ndërsa vajza po mban pemën. Përsëri, në të njëjtin tekst (faqe 97) në foto jepen dy djem dhe një vajzë. Dy djemtë po vendosin kafazin në pemë, ndërsa vajza po mban shkallën që të mos lëvizë (Dhamo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti, 2005).

Duket e zakonshme që djemtë të shihen në pozita drejtuese. Aty ku ata marrin iniciativa, ndërhyjnë dhe menaxhojnë situatat: janë komandantë (Dhamo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti, 2005).

3.1.7. Ilustrimet

Ilustrimet konsiderohen pjesë e rëndësishme e përmbajtjes së tekstit, veçanërisht të ciklit fillor. Ata rrisin fuqinë komunikuese. Fëmijët e moshës 6-11 vjeç mbështeten shumë te shqisa e të parit për të krijuar imazhe dhe për të përpunuar informacione. Ilustrimi, si gjuhë universale, u përcjell nxënësve mesazhe të drejtpërdrejta dhe shpeshherë sintetizuese, po aq sa edhe vetë fjala e shkruar, në mos më tepër. Për të mësuar faktet nga ilustrimi, fëmijët shqyrtojnë format, përmasat, ngjyrat, kontrastet dhe shoqërimin e pjesës së shkruar, me atë të vizatuar. Pozicioni i ilustrimit në faqen e tekstit, si edhe dominanca në figuracionin ilustrues dikton perceptueshmërinë dhe dallimin e tij. Vendosja e fakteve në kontekstin kohor dhe asociimi me tyre janë dukshëm, jo vetëm instrumente 'të fuqishme' të formimit të koncepteve, por edhe kushte të elasticitetit të përdorimit të asaj që mësohet.

Nisur nga parametrat psiko-socialë të moshës 6-10 vjeç, komunikimi me dhe përmes ilustrimit, shpesh është shumë më racional, më i drejtpërdrejtë dhe më i shpejtë, se edhe vetë fjala. Ilustrimi përforcon informacionin e lexuar dhe ndihmon në ruajtjen e informacionit të shkruar. Kur ky informacion jepet i shoqëruar me ilustrim, është më i lehtë dhe i predispozuar të ruhet më gjatë në kujtesë. Ilustrimet lidhen me kujtesën vizive, që mbetet shumë aktive gjatë gjithë jetës së njeriut. Deri në moshën 10 - vjeçare kujtesa është më e parapëlqyer; informacionet perceptohen dhe rezervohen më lehtë nëse vijnë përmes saj. Ajo funksionon përmes perceptimit viziv.

Perceptimi viziv është proces aktiv në të cilin informacioni ndijues përcillet në tru, ku dhe organizohet e interpretohet. Ai ndihmon procese konjitive, si: kujtesa, të menduarit dhe aftësinë për të formuar kuptim përmes procesit të të parit. Konteksti në të cilin perceptohen ilustrimet, prek mënyrën sesi pozicionohen fëmijët për ta parë, perceptuar dhe interpretuar informacionin. Pritshmëria perceptuese mendohet si kulmi i gjithë përvojave. Ajo udhëheq perceptimin për botën në mënyrë unike. Ilustrimet e përsëritura herë pas here, siç është rasti në librin e Abetares apo të Diturisë së Natyrës, ku periodikisht shfaqet një djalë me gishtin tregues të drejtuar lart, duket qartë

se dominon dhe dikton autoritetin që vjen nga mashkulli.

3.1.8. Skemat e të menduarit dhe sjellja

Sipas Dharmo, Sinani, Gjermani, Sulstarova, Sinani dhe Dauti (2005), studiuesja Sandra Ben, duke vëzhguar dallimet midis meshkujve dhe femrave, nënvizon se: fëmijët mësojnë jo vetëm përmbajtjen specifike të roleve gjinore, por dhe dallimet më të rëndësishme. Kjo skemë është një strukturë njohëse që shërben për të organizuar dhe udhëhequr perceptimet individuale. Në rast se kulturat nuk dallojnë midis sekseve në mënyrë që shumë shpejt për nxënësin, çdo gjë të jetë e ndarë në mashkullore dhe femërore, nxënësit nuk zhvillojnë e as përdorin më skemat gjinore.

Mënyra sesi janë parashtruar konceptet gjinore në tekstet e ciklit fillor, ndikon në qëndrimet dhe mënyrën e të kuptuarit të sjelljeve të përshtatshme. Tekstet përmbajnë seks-role që bien në konflikt me stereotipat gjinorë të nxënësve të caktuar, (një djalë i prirur të këndojë apo me dëshirë për t'u bërë infermier, nuk ka mundësi të gjejë veten në asnjë personazh gjatë teksteve, pasi tekstet operojnë me seks-role të fiksuara, si infermiere apo këngëtare që përgjithësisht janë femra). Po kështu, nuk gjen raste kur një vajzë të shfaqet duke luajtur me makinë.

Normalisht, në këtë situatë, ndodh disonanca konjitive: nxënësi riezaminon besimet gjinore. I/e pandihmuar, (dhe në fakt tekstet nuk i ndihmojnë ata të udhëhiqen në kënaqjen e disonancës konjitive) nxënësi mund të përfundojë të preferojë verbazi skemat e mësuara më parë mbi seks-rolet ose mund të zgjedhë të përshtasë qëndrime barazitare (egalitare).

Rolet tipike gjinore në tekste, në fakt, kërcënojnë të dyja palët: vajzat edhe djemtë. Ashtu si vajzat që duhet të jenë gjithnjë në role pasive dhe përgjithësisht të varura, edhe djemtë duhet të jenë në pozita dominuese: ata rrallëherë prezantohen të përjetojnë emocione të tilla, si: frika, trishtimi etj. Për shembull, nuk gjendet një djalë që qan. Këto stereotipa, në fakt nuk bëjnë gjë tjetër, veçse kufizojnë lirinë e vajzave dhe të djemve për të shprehur vetveten dhe i detyrojnë ata të përshtaten me konceptet e huazuara gjinore dhe jo me karakteristikat e personalitetit të gjithsecilit.

Nxënësit në këtë moshë, janë në procesin e ndërtimit të skemave mendore. Ata riorganizojnë njohuritë mbi njerëzit dhe eksperiencat sociale, dhe e ruajnë të organizuar informacionin e mbledhur. Brenda skemave, nxënësit organizojnë mendimet mbi rolet gjinore, stereotipat e sjelljes, opinionet dhe parashikimet për sjelljet tipikisht femërore a mashkullore. Këto ndikojnë në identifikimin e lexuesit/es t/së vogël me karakteret e gjinisë së tyre në çdo tekst. Kështu që, mungesa e larmisë së roleve gjinore femërore, kufizon

mundësinë që vajzat të identifikohen me gjininë e tyre dhe të vlerësojnë vendin që kanë në shoqëri. Në këtë kuadër, po të paraqiteshin në librat shkollorë tipare të përgjithshme dhe jo tipike femërore apo mashkullore, procesi i identifikimit dhe skemëformimit do të ishte më i favorizuar.

3.2. Perspektiva gjinore në teskte-si dhe ku?

Kur harton një tekst, autori/ja mban parasysh realitetin social të nxënësve. Teksti i tij/saj do të përdoret nga nxënës me prejardhje të ndryshme, nxënës të metropolit, por edhe të zonave ende tradicionale. Për të mundur një edukim të drejtë gjinor, autori/ja ndërthur në tekst dy format kryesore të plotësimit të nevojave të nxënësve:

- parashtrimin sistematik të informacionit gjinor, ku rolet gjinore përshkruhen drejtpërdrejt;
- parashtrimin problemor, ku nxënësit kanë mundësinë të ndërtojnë opinione, besime, bindje deri te vetëdija.

Nxënësit e vegjël, pa shumë informacion dhe përvojë ekspozimi ndaj roleve të drejta gjinore, mësojnë më mirë nga tekstet me parashtrime sistematike. Rolet gjinore të përshkruara sistematikisht në tekst (gra të suksesshme, burra përkujdesës) kanë fuqinë t'i udhëheqin skemat e të menduarit të nxënësve të vegjël në moshë dhe atyre që vijnë nga mjedise tradicionale dhe me stereotipa gjinorë. Ndërsa nxënësit me më shumë informacion për dimensionet e sjelljes së drejtë gjinore përfitojnë më shumë nga tekstet, që e parashtrajnë informacionin për burrat dhe gratë të fragmentarizuar në mënyrë problemore. Autori që iu drejtohet nxënësve të metropoleve mund të sjellë fragmente të larmishme rolesh dhe t'i inkurajojë nxënësit ta ndërtojnë vetë dijen mbi dimensionin gjinor të roleve. Ai kujdeset që të sjellë sa më shumë skema, ku burrat dhe gratë luajnë role të larmishme, pavarësisht gjinisë.

Autorët e teksteve për moshë më të rritura (12-18 vjeç) mbajnë parasysh se këta nxënës priren të venë në punë një potencial më të madh për të menduar në mënyrë të pavarur, kritike dhe abstrakte. Tekstet për këto moshë i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë skema të drejta gjinore.

Autorët i mbajnë parasysh proceset konjitive dhe strategjitë, që përdorin nxënësit gjatë të nxënës. Formimi i shprehive të sjelljes (përfshirë edhe sjelljen e drejtë në aspektin gjinor) kalon nëpër disa faza:

Marrja e informacionit nga teksti

Gjatë marrjes së informacionit nga teksti, nxënësit aktivizojnë procese të

tilla konjitive, si: perceptimi, eksplorimi i situatës, përqendrimi i vëmendjes në konceptet dhe mjetet verbale, hapësira, koha, konservimi i informacionit, mbledhja e të dhënave dhe shqyrtimi i burimeve të informacionit nga teksti dhe jeta. Siç shihet, nxënësit janë të varur nga aftësia e autorit/es për të qenë të qartë që në momentin e parë të prezantimit të informacionit. Nëse autori/ja nuk ka qartësuar ende me veten çështjet përkatësisë gjinore, renditja e informacionit do të jetë rastësore dhe do të ndihmojë shumë pak në arritjen e qëllimeve të edukimit.

Autori/ja sjell qëllimshëm informacion të organizuar në mënyrë të tillë që nxënësit të perceptojnë pikërisht ato detaje që i ndihmojnë të ndërtojnë skema të drejta gjinore. Ata nuk e neglizhojnë sjelljen e informacionit, por njëkohësisht mbajnë parasysh se informacioni do t'u jepet nxënësve me veçori të ndryshme perceptive. Për këtë alternohen forma të ndryshme, si: parashtrësë sistematike, parashtrësë problemore, informacion që rimerret, informacion argument, informacion konkluzion, informacion plotësues apo thelbësor. Në të gjitha rastet, autori/ja kujdeset për paraqitjen e drejtë dhe të plotë të informacionit.

Përpunimi i informacionit

Pasi e kanë marrë informacionin nga teksti, nxënësit fillojnë ta përpunojnë. Për këtë, ata aktivizojnë procese të ndryshme konjitive. Skemat gjinore fitohen pikërisht përmes përpunimit dhe manipulimit të informacionit të tekstit (asnjëherë i shkëputur nga shtresat e tjera të informacionit) me anë të strategjive të ndryshme mendore. Proceset që i ndihmojnë të formojnë shprehje me informacionin janë: përcaktimi i problemit/çështjes së paraqitur në tekst, ndjeshmërisë ndaj të dhënave dhe nxjerrjes së kuptimit prej tyre, krahasimi dhe përmbledhja spontane e të dhënave, organizimi i fushës së të menduarit, projektimi virtual i marrëdhënieve midis aspekteve të ndryshme të informacionit, zbulimi i raporteve/lidhjeve të fshehta midis të dhënave në të, logjika e të dhënave, brendësimi i elementeve të situatës, aktivizimi i të menduarit e brendshëm hipotetik, testimi i hipotezave me shumë strategji njëherazi, planifikimi i zgjidhjes dhe kapja e së vërtetës/zgjidhjes reale.

Autori/ia ia rrit shumëfish vlerën tekstit duke e renditur dhe parashtruar informacionin në forma të tillë që të ngacmojë pikërisht këto procese konjitive gjatë përpunimit të informacionit. Ilustruesi/ja ka të njëjtën ndjeshmëri ndaj nevojave të fëmijës për t'u ushqyer me informacion verbal dhe viziv njëkohësisht. Nëse nxënësi nuk ushqehet, të menduarit e tij është i fjetur dhe kujtesa tenton, në rastin më të mirë, ta shtyjë informacionin e papërpunuar në kujtesën afatgjatë, ku do të qëndrojë vetëm si klishe e gatshme për t'u riprodhuar, por i papërvetësuar dhe i papërshtatshëm për të formëzuar sjellje.

Duke ditur se disa prej nxënësve do të mund t'ia paraqesin vetes informacionin si një çështje për të menduar apo të zgjidhur, autori/ja i/e tekstit e pasuron informacionin edhe me të dhëna të pjesshme me të cilat nxënësit mund ta ndërtojnë vetë situatën problemore. Ai/ajo shmang sa të mundet nevojën për parashtrime sistematike dhe i lë vend parashtrimin problematik të informacionit që ka brenda edhe detaje gjinore.

Ndjeshmëria ndaj të dhënave është një predispozitë emocionale e gatshme për t'u aktivizuar gjatë përpunimit të informacionit. Ajo ka fuqinë ta shndërrojë informacionin në një vlerë të vërtetë. Autorët e plotësojnë informacionin në tekste me paraqitje të atilla që të ngacmojnë ndjeshmërinë ndaj roleve të ndara gjinore dhe vështirësive që sjellin ndarje të tilla në jetën e përditshme. Ndonjëherë ata sjellin edhe kotësinë apo pavlefshmërinë e burimeve të origjinës së stereotipave gjinore.

Krahasimi dhe përmbledhja e të dhënave gjinore është një proces konjitiv shumë spontan. Sa më i stërvitur të jetë fëmija, aq më i gatshëm është të angazhojë spontaneitetin në përpunimin e informacionit. Begatia e tekstit me informacione gjinore të ndjeshme dhe të larmishme dhe me ushtrime e situata të hapura shton shansin që të dhënat gjinore të krahasohen dhe klasifikohen të përmbledhura.

Projektimi virtual i marrëdhënieve mes gjinive në fushën e të menduarit është një proces tjetër konjitiv, që ndihmon të përvetësohet informacioni mbi përkatësinë gjinore. Kur lexojnë, nxënësit e vendosin domethënien e tekstit në një fushë mendore (p.sh., marrëdhëniet shoqërore, familjare, rolet sociale etj., që projektohen në një fushë të ndërtuar me skemat ekzistuese të krijuara nga përvoja jetësore e tyre) dhe, prej së cilës nxjerrin domethënien e marrëdhënieve mes aspekteve të informacionit (projektohen marrëdhëniet e përshkruara në pjesën e tekstit në kontekstin familjar, social etj). Ky është një moment i artë që i ndihmon të shikojnë logjikën e marrëdhënieve në fushë dhe të bëjnë të tyret elemente të situatës së përshkruar në tekst.

Kështu, nxënësit frymëzohen të mendojnë në mënyrë hipotetike dhe të orientojnë të menduarit rreth gjetjes së përgjigjeve/ konkluzioneve të pranueshme/dëshiruara për ta. E thënë shkurt, kjo është ajo që ndodh me proceset mendore kur nxënësit lexojnë në mënyrë aktive një tekst të ndërtuar për të plotësuar pikërisht nevojat e tyre për të aktivizuar të tilla procese. Autorët e ndihmojnë të brendësojnë në mënyrë kritike role dhe modele gjinore.

Aktualizimi i roleve gjinore

Përgjithësisht, thuhet se të nxënët nuk është i vërtetë derisa sjellja e re e mësuar të mos jetë e dukshme. Nga tekstet kërkohet t'i ndihmojnë nxënësit

të formojnë shprehi të reja sjelljeje gjinore. Për t'i inkurajuar nxënësit të bëjnë përpjekje për një fazë të tretë të përvetësimit të informacionit, autorët kujdesen që teksti të pajiset edhe me një aparat pedagogjik, që jep shanse për përpunim dhe mëshërim të roleve të drejta gjinore. Kjo fazë e të nxënësve synon përdorimin e informacionit të tekstit nga nxënësit. Teksti duhet të japë shanse që nxënësit të identifikojnë dhe përdorin forma të reja komunikimi, që respektojnë djemtë dhe vajzat për çka janë, lejojnë shprehjen e emocioneve gjatë luajtjes së një roli të ri gjinor në klasë, shkollë, familje, shoqëri; inkurajojnë reagimet e drejta gjinore, lejojnë përjetimet personale gjatë aktualizimit të roleve gjinore, përsosin instrumentet e shprehjes verbale, mundësojnë komunikimin e gjetjeve gjinore në grup dhe bëjnë të mundur që çdo nxënës, pasi të jetë ekspozuar me informacionin e drejtë, të mund të ndjehet mirë me rolin gjinor që merr përsipër.

Hartuesit/es së tekstit i kërkohet t'i kushtojë kujdes orientimit të nxënësve në role e sjellje të reja gjinore. Ai/ajo udhëzon përmes detyrash që nxënësit të identifikojnë format e komunikimit mes gjinive dhe t'i modelojnë ato. Në përshtatje me moshën dhe lëndën autori/ja mund të sugjerojë hapjen e diskutimeve mbi atë që ndiejnë djemtë dhe vajzat gjatë realizimit të një roli (androgjinik apo tradicional), mbi reagimet tipike gjinore etj.

Përsosja e instrumenteve verbale dhe vizive përmes të cilave nxënësit realizojnë shprehjen e vetes gjinore është një detyrim i madh i autorëve të teksteve dhe mësuesve. Autorët inkurajohen të shtojnë ushtrimin e shprehjes së nxënësve mbi çfarë mendojnë dhe ndiejnë në forma të ndryshme: me shkrim, projekte, verbalisht, në grupe të vogla dhe/apo të mëdha etj. Ata gjejnë forma të inkurajojnë instalimin e psikologjisë “unë...” dhe kufizimin e psikologjisë “mua më...” te fëmija, sidomos te vajzat. Ushtrimet përmes të cilave nxënësi/ja inkurajohet të punojë për të kristalizuar veten asertive, ose ndryshe e drejtpërdrejtë, përmes përdorimit të përemrit “unë vajzë/unë djalë” kanë vend pothuajse në të gjitha lëndët. Autorët shmangin modelet e ushtrimeve që i vendosin nxënësit në pozitat e riprodhuesve të informacionit nga pozita të ndara gjinore: “Mua më... (vajzë)/Unë...(djalë)” .

3.3. Përditësimi i dimensionit androgjenik në përvojën vetjake

Formimi/edukimi i fëmijëve si të ndryshëm në aspektin gjinor, në jetën e përditshme, bën që skemat respektive mendore të formohen të ndryshme. Kur përballen me një informacion, djali dhe vajza aktivizojnë skema të ndryshme. Një djalë përvetëson informacionin dhe role me skema që një vajzë nuk i ka, ndërsa një vajzë me skema që një djali as nuk i shkon mendja kurrë se ekzistojnë. Kështu djali dhe vajza rriten të ndryshëm. Kur vijnë në shkollë,

pavarësisht se shikojnë të njëjtin burim informacioni, përfundimisht djali mëson si të nisë makinën, ndërsa vajza mëson si të hekursosë një këmishë. Kur janë përballë një informacioni që ka brenda edhe këmishën edhe makinën, vajza dhe djali aktivizojnë skema të ndryshme, të fituara në të përditshmen e renduar me stereotipa gjinorë, gjë që i bën të arrijnë rezultate të ndryshme.

Teksti ka detyrë të tejkalojë të përditshmen e zakonshme, duke sjellë botën e drejtë të marrëdhënieve gjinore. Por ai nuk mund të ndalojë aktivizimin e skemave ekzistuese të të menduarit. Një tekst i mirë kënaq të dy format kryesore të përpunimit të informacionit: përvojën vetjake dhe racionalitetin. Ai ka brenda edhe artikullimin abstrakt mbi gjinitë, shembullin dhe ilustrimin. Kështu ai plotëson edhe nevojën e nxënësve hemisferëdjathtë për më shumë shembuj konkretë dhe shanse për përvojë individuale, edhe nevojat e fëmijës hemisferëmajtë, që ka nevojë për më shumë racionalizim mbi dallimet gjinore dhe pasojat.

Autorët e teksteve duhet të sigurohen që në tekstin e tyre të ketë mjaftueshëm situata, në përshatje me moshën e nxënësve dhe pavarësisht lëndës, ku arsyetohet rreth të drejtës dhe barazisë gjinore. Për çdo ekspoze me aspekte gjinore ata sjellin shembuj dhe ilustrime të përpunuara që fëmijët dhe të rinjtë t'i ndjekin si modele. Për çdo rast të paraqitjes së gjinisë, autorët e lejojnë apo inkurajojnë kritikën, diskutimin dhe zgjedhjen. Ata udhëzojnë që pasi të kenë mbaruar veprimtari të ndryshme, të flasin për çfarë ndien, provuan dhe mbajtën mend nga veprimtaria. Autorët i ndjekin çështjet e përkatësisë gjinore përgjatë një seti mësimesh. Nëse fillon në mësimin e parë të kapitullit një kërkesë që synon ndjeshmërinë gjinore, ajo duhet pasuar edhe në mësimet pasardhëse.

Është e rëndësishme të përmendet këtu fakti se çështjet e përkatësisë gjinore nuk dalin pandërprerë përgjatë gjithë tekstit. Edukimi gjinor rimerret kohë pas kohe në tekst, duke mundësuar një rikthim të herëpashershëm dhe të përqendruar në çështjet e përkatësisë gjinore.

IV. Rekomandime për shtëpitë botuese të teksteve shkollore

4.1. Vizibiliteti / Dukshmëria

Kur shkruhet/botohet apo redaktohet një tekst duhet mbajtur në mendje se gjysma e popullsisë janë gra edhe vajza. Minimalisht, ky raport respektohet në përmbajtjen e tekstit edhe në ilustrime, duke bërë të mundur që secili/a prej tyre të zënë vendin e duhur.

Për të prezantuar gratë dhe burrat në mënyrë të balancuar në tekste është e nevojshme të bëhen disa ndryshime dy prej të cilave janë më kryesore. Punët në të cilat gratë edhe vajzat tradicionalisht janë më shumë të përfshira nuk mund të nënvlerësohen apo të mbeten të padukshme, por e rëndësishme që këto që kontribuojnë në mbarëvajtjen e familjes të mos kufizohen vetëm në sferën private edhe familjare. Po kështu, edhe burrat edhe djemtë të marrin rolet e tyre brenda familjes jo vetëm si siguruesit kryesorë të të ardhurave, por edhe si anëtarë aktiv në familje. E dyta, gratë edhe vajzat, po aq sa kontribuojnë në familje janë të pranishëm realisht (duhet të jenë prezentë edhe në tekste) të paraqiten edhe në sferën publike në pozicione dhe role të cilat dëshmojnë aftësitë e tyre.

Vëmendja për ilustrimin e teksteve shkollore, mendohet se duhet të fokusohet në pyetjet e mëposhtme:

Cilat janë mesazhet gjinore që përfaqëson ilustrimi në tekst? Sa të pranishme janë ilustrimet, që përcjellin imazhin e grave dhe burrave? Në cilat role e përcjellin? Në cilat role sociale i shikojmë gjininë mashkullore dhe femërore në ilustrimet e tekstit? A është teksti i dominuar nga ilustrime që përcjellin figurën e femrës apo të mashkullit?

4.2. Stereotipat

Kur shkruani, redaktoni, apo botoni një tekst mundohuni të shmangni atribuimin e tipareve specifike të personalitetit apo temperamentit të një seksi.

Realiteti tregon se individët janë shumë kompleksë dhe nuk mund të paraqiten thjesht me tiparet tradicionale femërore dhe/apo mashkullore. Faktorë të tjerë siç janë: moshë, gjendja ekonomike, përkatësia etnike, apo fetare,

vendndodhja gjeografike, tiparet individuale të personalitetit ndikojnë realisht tek individët edhe rolet, që marrin në familje edhe në shoqëri. Përkatësia gjinore është vetëm njëri prej tyre, shpeshherë jo kryesori.

Individët, qofshin gra apo burra, në radhë të parë, duhen konsideruar si qenie njerëzore me të gjitha cilësitë e tyre jo domosdoshmërisht si qenie femërore apo mashkullore, duke i veshur stereotipa tradicionalë. Ashtu siç mund të paraqitet një grua, që fiton në zgjedhjet parlamentare apo vendore, e cila në të njëjtën kohë ofron edhe dashuri për fëmijët, po kështu mund të paraqitet një burrë që tregon forcën edhe aftësitë e tij duke punuar jashtë shëpisë, por edhe brenda në shtëpi. Për ta bërë tekstin sa më real duhet të zënë vend edhe vështirësitë apo sfidat me të cilat përballen gratë edhe burrat, duke u përpjekur të hyjnë më shumë, respektivisht, në sferën publike dhe private.

Në tekste duhet gjetur mënyra që gratë të mund të vlerësohen për iniciativën, vetëkontrollin, asertivitetin, vendosmërinë, ndërkohë që burrat të mund të vlerësohen edhe për ndjeshmërinë, shprehjen e emocioneve apo të përkushtimit.

4.3. Marrëdhëniet

Marrëdhëniet njerëzore janë shumë komplekse dhe të ndërlikuara. Duke qenë të tilla duhen përfshirë në tekste dinamikat e tyre që të mund të kuptohen nga nxënësit sipas moshës edhe formimit të tyre. Veç kësaj marrëdhëniet shoqërore edhe ato familjare janë në ndryshim të vazhdueshëm. Këto ndryshime apo tendencat e tyre duhen paraqitur në tekste.

Mundet që të përfshihen:

- Forma të ndryshme të familjeve: familje të mëdha, familje nukleare, prindërit të vetëm, duke i vlerësuar njësoj pa paragjykimë.
- Familje nga zonat rurale edhe urbane.
- Nxënësit nën kujdesin e nënave edhe të baballarëve.
- Vajzat në pozicionin e drejtueseve në lidhje më vajzat e tjera dhe djemtë, po aq shpesh sa edhe djemtë drejtues.
- Gratë dhe burrat, duke kontribuar në të ardhura për jetën familjare.

4.4. Profesionet

Duhet bërë një përpjekje që të thyhet ndarja gjinore sipas profesioneve, duke i konsideruar disa prej tyre si “femërore” edhe disa si “mashkullore”. Gratë, ashtu si burrat, mund të paraqiten në profesione, si: ekonomist, juriste, inxhinierë, pilote, gazetarë, operatore kompjuterësh, mjekë, deri

dhe austronaute; ndërsa burrat, ashtu si dhe gratë, mund të jenë infermierë, mësues në shkollën fillore, sekretarë, daktilografistë etj.

4.5. Detyra praktike

Për të integruar përvojat personale me përvojat e dëshiruara në tekste mund të përfshihen detyra të tilla, si:

- Shkruaj rastin tënd!
- Nëse pret që nxënësi/nxënësja të marrë një rol të ri në familje, grup apo klasë shkruaj hapat, të cilat duhet të ndjekë që të mos jetë i/e dështuar në përpjekjen e tij/saj: (p.sh.: nëse një djalë do të përgatisë drekën në familje, ai duhet të gjejë në tekst një recetë ose udhëzim).
- Kërkoju nxënësve të sjellin në klasë përvojën e tyre me rolin e ri!
- Sugjerojuni nxënësve një strukturë të prezantimit:
 - Nga roli i ri që mora përsipër këtë fundjavë, do të kujtoj gjithmonë...
 - Kjo sepse...
 - Nuk e di nëse do të jem në gjendje ta përsëris të njëjtin rol në një situatë kur...
 - Megjithatë, unë gjej forca te vetja pasi unë...
 - Dhe pyetja ime për mësuesin/ shokët/prindërit është...
- Hidh copëza fjalësh dhe situatash, dhe nxiti nxënësit që t'i bashkojnë ato në histori personale.
- Sill copëza leximi pa mbyllje që nxënësit të gjejnë vetë zgjidhjen apo fundin e pjesës.
- Plotëso tekstin me modele të rolit të drejtë gjinor.

Në tekste nxënësit duhet të gjejnë njohuri, aftësi e shprehje që zbatohen në jetën e përditshme. Nëse rolet gjinore synohet të përdoren edhe në mjedise larg klasës dhe mësuesit, teksti duhet të sjellë aspekte të sjelljes së drejtë gjinore në mjedise tipike, të inkurajojë nxënësit të mësojnë së pari aspekte të sjelljes androgjinike përmes roleve dhe punës në grupe.

4.6. Aparati pedagogjik i tekstit

Çdo tekst ka një aparat pedagogjik që përsëritet periodikisht nga njëra njësi mësimore tek tjetra. Këtë rubrikë e gjejmë të etiketuar në trajta të ndryshme si: “Pyetje dhe detyra” “Ndaluni dhe diskutoni”, “Ndani mes jush”, “Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme”, etj.

Këto rubrika mbështeten në pyetje (seri - pyetjesh), të cilat synojnë të vendosin një marrëdhënie të nxënësit/es me atë që ka mësuar nga teksti gjatë njësisë mësimore në biseda. Pyetjet përgjithësisht operojnë me taksonomitë e Bloomit, dhe tentojnë të verifikojnë te çdo nxënës, kujtesën, aftësinë riprodhuese të njohurive të marra, aftësitë krahasuese, analitike etj.

Nga analiza e teksteve të shkollës fillore dhe atyre të ciklit të mesëm, rezulton se aparatit pedagogjik të teksteve pothuajse i mungon taksonomia afektive. Taksonomia afektive nënkupton një seri pyetjesh, që kthen sytë e brendshëm të nxënësit/es për të identifikuar dhe zbuluar veten, dhe të tjerët.

Pyetjet afektive e ndihmojnë nxënësin/en, të shkojë tek identifikimi i asaj që mësojnë me atë që kanë ditur përmes dhe nga burime e rrugë të tjera. E tillë është:

- A njeh rast të ngjashëm me atë të tekstit?

Përgjithësisht, pyetjet në tekste priren të kërkojnë vetëm miratim të informacionit të tekstit, por nuk lënë hapësira për diskutim, ballafaqim dhe analizë nga nxënësi/ja. Nëse nuk gjejmë në tekst pyetje, si:

- *Veço personazhin që ngjan me ty dhe thuaj pse.*
- *Si do të kishit reaguar në një situatë të tillë?*
- *Nëse do të ishit grua/burrë çfarë vendimi do të kishit marrë?*
- *A do te ndiheshit më mirë të mos ishit vajzë/djalë në një rast si ky i tekstit?*

Këto forma e orientojnë nxënësin/en ta portretizojë femrën/mashkullin nga këndvështrimet e tyre personale. Të organizuara disi ndryshe pyetjet i ngacmojnë nxënësit të analizojnë përkatësitë dhe identitetet gjinore, dhe në grup moshë me të rritura, edhe krizat e identitetit gjinor.

Këto ndihmojnë mësuesin/en për t'i dhënë më shumë hapësirë vetë tekstit, duke zhvilluar dhe dimensionet e tjera që atij i mungojnë. Në këtë situatë mësuesi/ja bëhet jo vetëm përcjellës i tekstit, por dhe zhvillues i tij bashkë me nxënësit.

Jo rrallë nëpër tekste, nëse ndalesh dhe hulumton vetëm tek aparati i pyetjeve, konstaton lehtësisht se

- ato lënë jashtë mundësisë për përgjigje njërin gjini kundrejt tjetrës;
- ato nuk mbulojnë objektivat e fshehtë të kurrikulës, aspektin social, veçmas, atë gjinor;
- ato përforcojnë diskriminimin gjinor (kur drejtohen: ndani me shokun... këtë gjë...);
- nuk mbulojnë plotësisht sa interesat e djemve, po aq dhe të vajzave.

4.7. Listë kontrolli për autorët gjatë procesit të hartimit të teksteve mësimore

- A transmeton teksti vizionin e një shoqërie me mundësi të barabarta zhvillimi, si djemve/vajzave, burrave/grave?
- A dominohet teksti nga stereotipa gjinorë?
- A ka në tekst gra/burra nga raca, gjinia, grupe etnike, përkatësia fetare të ndryshme?
- A paraqiten djemtë/vajzat, burrat/gratë me të njëjtën (frekuencë)?
- A ka *portrete stereotipike*, që e shpërfillin apo nuk e shprehin barazinë gjinore?
- A i diskriminon gjinitë gjuha e përdorur në tekste?
- A paraqiten të barabartë në vendimmarrje si burrat, ashtu edhe gratë?
- A jepen situata të dilemave gjinore në tekst dhe a shoqërohen ato me pyetje?
- A kanë hapësirë dhe vlerë të njëjtë rolet dhe detyrat, që kryejnë gratë dhe burrat në shtëpi, në punë dhe në komunitet?
- A është shmangur fokusimi te flokët dhe pamja e personazheve femërore?

I nderuar autor/e teksti.

Kujdesuni që në çdo tekst nxënësit të gjejnë qëllimet finale të një sistemi arsimor, konkretisht të sistemit tonë, përfaqëson jo vetëm një parim, por dhe pikënisje për autorët e teksteve shkollore.

Ky parim duhet kuptuar në mënyrën që autorët të respektojnë:

- Zhvillimin e pavarur të të menduarit të çdo nxënësi/eje;
- Zhvillim individual të çdo nxënësi, vajzë/djalë;
- Zhvillim dhe përcjellje të vlerave bazë të shoqërisë për të dyja gjinitë;
- Perspektiva dhe projeksione, që vijnë nga të dy gjinitë dhe që potencialisht nxisin zhvillim të dy gjinive.

Të gjitha elementet e tekstit, pjesët e leximit, situatat e rastit, shembujt, ilustrimet, pyetjet dhe faqosja e materialit, ndikojnë drejtëpërsëdrejti në formimin e skemave të të menduarit të çdo inividi, pra, te personalitetit të nxënësit/es. Nëse një tekst i caktuar i jep përparësi vlerave vetjake, ndërvetjake, por, lë jashtë të qenit vajzë/djalë (përkatësinë dhe identitetin gjinor), atëherë teksti në fjalë, nuk e kryen siç duhet dhe deri në fund detyrimin për të zhvilluar personalitetin e nxënësit/es, nën perspektivën gjinore.

Rekomandohet të aplikohen dhe ilustrime me tematikë nga problemet gjinore përfaqësuese, që e paraqesin situatën apo konfliktin gjinor vetëm përmes vizatimit të thjeshtë, pa përdorur tekstin. Mendohet se kanë një funksion mjaft eficient.

Kujtesë!

Vendosni në tekst me qëllime të caktuara ilustrimin. Formuloni sa më shumë pyetje që rrjedhin gjatë shikimit të ilustrimit. Nxitni nxënësit të vendosin diçiturën e duhur.

Vëmendja për trajtimin e ilustrimit në tekstet shkollore duhet të fokusohet në përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme:

Cilat janë mesazhet gjinore që përfaqëson ilustrimi në tekst? Sa të pranishëm janë ilustrimet që përcjellin imazhin e grave dhe vajzave? Në cilat role e përcjellin? Sa përcjellin imazhin e burrave dhe të vajzave? Në cilat role sociale i shikojmë gjininë mashkullore dhe femërore në ilustrimet e tekstit? A është teksti i dominuar nga ilustrime që paraqesin figurën e femrës apo të mashkullit?

Gjatë zhvillimit të tekstit, autorët prirën të veçojnë ilustrimet e tij, duke i vënë ato në qendër të diskutimit me fokus përkatësinë gjinore. Por bëhet kujdes të veçohen ato ilustrime, që krijojnë më shumë mundësi për diskutim. Autorët tentojnë të rekomandojnë cilat nga ilustrimet e tekstit vlejnë të veçohen dhe cilat janë mënyrat e rrugët për të nxitur sa më shumë diskutim rreth tyre. Emocionalisht teksti është i varfër nëse ka pak ilustrime, sepse nuk përcjell te nxënësi/ja emocionet dhe për më tepër, nuk u krijon shumë hapësira mësuesve të ndërtojnë pyetje për nxënësit dhe refleksione të mjaftueshme me ta.

Nga pikëpamja e marrëdhënieve të autorit/es me ilustruesin/en, duhet nënvizuar fakti se puna për ta (të dy palët) fillon në të njëjtën kohë me të njëjtin intensitet dhe mbaron po në të njëjtën kohë. Kjo na bën të pranojmë përfundimin se autori/ja duhet dhe mundet të ndajë me ilustruesin/en suksesin apo mospushtesin e tekstit.

4.8. Listë kontrolli për ilustruesit gjatë procesit të hartimit të teksteve mësimore

- Cila është kopertina e tekstit tim? Mesazhi?
- Si është raporti numerik i vajzave dhe djemve në tekst?
- A janë ilustrimet të sfumuara apo jo të qarta?

- A është treguar kujdes me siglat e përdorura në tekst, me qëllim që të mos përdoret vetëm njëra dhe tjetra të përjashtohet (teksti i muzikës)?
- A është treguar kujdes me ilustrimet dhe statuset që percjellin ata (në familje, komunitet, profesione), po me një ekuilibrim qoftë edhe numerik?
- Ç'mendim keni për ilustrimet, që percjellin grupe mikse (heterogjene) lidhur me përkatësinë gjinore?

Kujtesë!

- Bëni bilancin e proceseve të punës suaj si ilustrues/se.
- Ballafaqoni veten me punën që keni berë.
- Kontrolloni frekuencën e ilustrimeve që keni përdorur.

Në përdorimin e ilustrimeve në tekste, përpiquni të mbani një ekuilibër të grave edhe burrave, vajzave edhe djemve si në numrin e tyre, në madhësinë e figurave, mënyrën e prezantimit, mjedisin ku paraqiten etj.

4.9. Listë kontrolli për redaktorët shkencorë gjatë hartimit dhe redaktimit të teksteve mësimore

- A i orientojnë pyetjet nxënësit për të portretizuar femrën/mashkullin në mënyrë tipike në gjendjen që është?
- A i ftojnë pyetjet nxënësit të analizojnë krizat e identitetit gjinor?
- A i lënë pyetjet jashtë mundësisë për përgjigje njërën gjini kundrejt tjetrës?
- A i mbulojnë pyetjet objektivat e fshehtë të kurrikulës në aspektin gjinor?
- A e përforcojnë pyetjet diskriminimin gjinor, apo mbulojnë sa interesat e djemve dhe të vajzave?

Përfundime

a) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore marrin detyrimin që të angazhohen për të respektuar dhe për të referuar dhe përcjellë detyrimet që rrjedhin nga dokumente ligjore që udheheqin arsimin parauniversitar si:

- Korniza Kurrikulare (dokument bazë për politikën arsimore në arsimin parauniversitar) ku parashtrihen filozofia, dimensionet dhe fryma e kurrikulës në përgjithësi, veçmas edukimi gjinor.
- Kurrikulat Lëndore dhe objektivat specifike, që përcjellin dimensionin gjinor në varësi të specifikave dhe profilit të secilës lëndë.
- Udhëzuesit kurrikularë, ku specifikohet konkretisht se ku dhe në çfarë mase duhet “bërë kujdes” për një edukim gjinor të balancuar edhe pa stereotipa.

b) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore marrin detyrimin:

- Të përfshijnë në kontratat e përgatitura prej tyre, me ekipet e hartuesve të teksteve (autorë, faqosës, redaktorë etj.) detyrimin për të përcjellë dimensionin gjinor në tekste konform detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet zyrtare të përmendura më lart.
- Kontratat me autorët, të cilat nuk mund dhe nuk duhet të përfshijë vetëm elemente që lidhen me afatet kohore, sistemin e pagesës dhe shpërndarjes.
- Kontrata lipset të nënvizojë detyrimin e autorëve për të aplikuar jo vetëm taksonominë konjitive, por dhe taksonominë afektive, e cila ndihmon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e personalitetit dhe dimensionit social të nxënësit/es.

c) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore e kanë të nevojshme të ngrenë grupe të hartimit të tekstit në përbërje të cilave të jenë në të njëjtën kohë autorët, ilustruesit dhe redaktorët, pasi vetëm kështu do të funksionojnë si ekip dhe do të sinkronizojnë veprimtarinë për hartim cilësor të teksteve.

d) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore duhet të angazhohen në:

- trajnime periodike të grupeve të autorëve me çështje, që lidhen me tendencën të reja, të cilat kërkohet të përcillen në tekste.

e) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore duhet të shfrytëzojnë mundësitë për të ngritur grupe specialistësh për tekstet në përbërje të cilave të përfaqësohen sa më shumë të jetë e mundur, autorë me gjini të ndryshme.

Referencat

Davies, B. (1995). Gender Bias in School Text Books. London, UK: Commonwealth Secretariat. pp. 81-94.

INSTAT (2005). Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (2008). Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (2007 - 2010). Tiranë: UN Albania.

OSBE (2004). Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit.

Qendra e Gruas (2003). Manuali i Trajnimit - Niveli Fillestar. Tiranë: I pabotuar.

Qendra e Gruas (2003). Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Tiranë: I pabotuar.

Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (2004). Përkatësia gjinore dhe zhvillimi - koncepte dhe përkufizime. Tiranë: PEGI.

Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (2007). Paketë burimore mbi përkatësinë gjinore. Fjalorth Termash. Tiranë: PEGI.

Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave (2007). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007 - 2013). Draft për Konsultim Publik.

UNDP (2005). Toward universal primary education: Investments, incentives, and institutions, Achieving the Millennium Development Goals, Task Force in Education.

V. Anekse

5

Aneks 5.1. Kontrata tip



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
KABINETI I MINISTRIT

SHTËPIA
BOTUESE

Nr. _____ Prot Tiranë, më ___/___/ 2008

Nr. _____ Prot Tiranë, më ___/___/ 2008

K O N T R A T Ë

Sot, më datë _____ 2008, në Tiranë, lidhet kjo kontratë, midis palëve:

MASH: *Ministria e Arsimit dhe e Shkencës* (më poshtë e quajtur MASH), e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm _____

dhe

BOTUESIT: Shtëpia Botuese _____ (më poshtë e quajtur BOTUESI), e përfaqësuar nga _____

BAZA LIGJORE E KONTRATËS

Ligji nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 850 e vijues, Ligji Nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar” i ndryshuar, Ligji Nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të” VKM Nr.260, datë 18.04.2007 “Për Botimin, Shtypjen dhe Shpërndarjen e Teksteve Shkollore të Sistemit Arsimit Parauniversitar”.

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është sipërmarrja e BOTUESIT për botimin, shpërndarjen dhe shitjen tek nxënësit e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar të tekstit “.....” shpallur i miratuar nga MASH-i nëpërmjet Bordit të Miratimit të Teksteve Shkollore (BOMIT) pranë kësaj Ministrie.

Neni 2

TË DHËNAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJË TEKSTI

Specifikimet teknike minimale që do të plotësojë teksti në përfundim të procesit të

shtypjes janë:

- Formati i librit: _____
- Blloku i librit
Numri i ngjyrave: _____
Gramatura e letrës: _____
- Kopertina e librit:
Numri i ngjyrave: _____
Lloji dhe Gramatura e kartonçinës: _____
-
- Lidhja e librit: _____

Neni 3

ÇMIMI I TEKSTIT

Çmimi i shitjes me pakicë i tekstit të jetë jo më i lartë se _____ lekë.

Neni 4

ÇERTIFIKATA E LEJES E TEKSTIT

1. Teksti duhet të ketë fituar Çertifikatën e Lejes për t'u futur në tregun e shitjes. Certifikimi i tekstit bëhet nëpërmjet BOMIT-it përpara se teksti të shitet dhe përpara se të shpërndahet nga BOTUESI për përzgjedhje nga Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KOPT) në shkollat.
2. Botuesi detyrohet që, deri në marrjen e Çertifikatës së Lejes për këtë tekst, të plotësojë të gjitha vërejtjet sipas rastit, nëse ka të tilla, të cilat do t'i jepen nga BOMIT-ti. Certifikata e Lejes është e vlefshme për aq kohë sa janë në fuqi të njëjtat programe lëndore por jo për më pak se 2 (dy) vjet nga koha në të cilën ato janë vendosur ose janë ndryshuar për herë të fundit, përveç rasteve kur leja e dhënë është shfuqizuar në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë kontratë.
3. Kur teksti kërkohet të ribotohet me ndryshime që e kalojnë 15% të masës së tij, atëherë teksti i nënshtrohet procesit të miratimit dhe certifikimit sikurse çdo tekst tjetër.

Neni 4/1

PULLA E ÇERTIFIKIMIT

1. Në çdo kopje të tekstit të çertifikuar, vendoset pulla e çertifikimit, e cila jepet nga MASH-i përkundrejt pagesës në vlerën e kostos së blerjes nga MASH-i.
2. Kopjet e tekstit që do të futen në treg duhet të kenë pullën e çertifikimit të ngjitur në kopertinë.

Neni 5

TË DREJTAT E PALËVE

A. MASH-i ka të drejtë:

1. Të përfshijë në sistemin konkurrues edhe tekste të tjera alternative, që përfitojnë miratimin dhe çertifikimin përmes BOMIT-it.

2. Të ndryshojë kohë pas kohe programet, por jo më shpejt se dy vjet nga koha në të cilën ato janë vendosur ose janë ndryshuar për herë të fundit. Në këtë rast, MASH-i ka të drejtë të kërkojë plotësimin e tyre edhe në këtë tekst.
3. Të kontrollojë herëpashere cilësinë e kopjeve të tekstit të hedhura në qarkullim për të verifikuar përmbushjen e standardeve të miratimit.

B. BOTUESI ka të drejtë:

1. Të zotërojë, së bashku me autorin/autorët e tekstit, të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale mbi tekstin dhe si mall në shitje (kopirajtin), e drejtë e rregulluar në kontratën ndërmjet tyre dhe e mbrojtur nga ligjet në fuqi.
2. Të bëjë përmirësime të tekstit, duke e ndryshuar atë në ribotimin e tij, pa qenë nevoja të paraqesë tekstin rishtas për miratim, nëse këto ndryshime nuk kalojnë 15% të variantit të miratuar.
3. Ta nxjerrë tekstin në shitje të lirë vetëm nëse, paraprakisht, e ka paraqitur tekstin në sistemin e përzgjedhjes në shkolla dhe ka përmbushur porosinë e shkollave për këtë tekst sipas gjeografisë së kërkesave, të konfirmuara nga drejtori i shkollës përkatëse.
4. Të kërkojë nga MASH-i zbatimin korrekt dhe transparent të rregullave të sistemit, që kanë të bëjnë me procedurat e miratimit dhe të përzgjedhjes së teksteve.

Neni 6

DETYRIMET E PALËVE

A. MASH-i detyrohet:

1. T'i japë BOTUESIT vërejtjet e sugjerimet e bëra nga vlerësuesit e tekstit, por pa dhënë pikët dhe pa zbuluar identitetin e vlerësuesve, pasi BOTUESI bën kërkesë me shkrim.
2. Të kryejë kontrollin përfundimtar të përmbajtjes dhe të specifikimeve teknike nëpërmjet BOMIT-it dhe në rast të përmbushjes së standardeve, t'i japë BOTUESIT Certifikatën e Lejes, brenda 1 jave nga data që BOTUESI dorëzon kërkesën me shkrim dhe dy kopje të tekstit të shtypur.
3. Të përfshijë tekstin e miratuar në Katalogun e Botimeve Shkollore, pasi të jetë lëshuar Certifikata e Lejes.
4. Të pajisë BOTUESIN me listën e shkollave që mund ta përzgjedhin këtë tekst në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Të marrë masat me shkollat, DAR-et ose ZA-të për funksionimin e rregullt të strukturës së përzgjedhjes së teksteve nga shkollat, si dhe të krejt sistemit.
6. Në rastin kur teksti është për shkollat e pakicave kombëtare ose shkollat e mesme profesionale, të marrë masa që shkollat, DAR-et ose ZA-të të kryejnë pagesat ndaj BOTUESIT për tekstet e furnizuara sipas porosive të shkollave jo më vonë se 15 tetori 2008, nëse teksti subvencionohet tërësisht nga shteti, dhe jo më vonë se 01 nëntori 2008, nëse teksti subvencionohet pjesërisht nga shteti.
7. Të mos pengojë ose ndalojë me asnjë lloj forme, shitjen ose përdorimin e tekstit nga shkollat me qëllim favorizimin në mënyrë të njëanshme të botuesve të tjerë.
8. Të ndjekë një politikë të barabartë dhe të drejtë me të gjithë botuesit, të cilët do të fitojnë të drejtën e botimit, shtypjes dhe shitjes së tekstit tek nxënësit për përdorim në shkolla.

B. BOTUESI detyrohet:

1. Që, me mjetet e tij dhe duke marrë përsipër rrezikun, të prodhojë tekstin dhe ta shesë atë sipas kërkesave të shkollave
 - a) duke respektuar sistemin e përzgjedhjes së tekstit prej tyre,
 - b) duke përmbushur porosinë e shkollave
 - c) duke mos u tërhequr nga këto detyrime në asnjë fazë të përmbushjes së tyre.
2. Të mos ia kalojë të drejtat e këtij teksti një botuesi tjetër, pa marrë më parë pëlqimin e MASH-it, për aq kohë sa Certifikata e Lejes është e vlefshme.
3. Të paraqesë pranë BOMIT-it 2 kopje të tekstit të shtypur për verifikimin e cilësisë së përmbajtjes dhe asaj fizike, me qëllim që të marrë certifikatën e lejes. Për të marrë këtë certifikatë, BOTUESI është i detyruar të ketë respektuar në mënyrë të rreptë standardet gjuhësore dhe shkencore, specifikimet teknike sipas nenit 2, çmimin e miratimit sipas nenit 3, si dhe kërkesat e tjera të kësaj kontrate për elementet që duhet të përmbushë çdo kopje e tekstit , të cilat përshkruhen në pikat B6, B8 të nenit 6.
4. Të mos e fusë tekstin në sistemin e përzgjedhjes në shkolla dhe të mos e nxjerrë atë në shitje pa marrë Certifikatën e Lejes.
5. Të mos e fusë tekstin në sistemin e përzgjedhjes në shkolla dhe të mos e nxjerrë atë në shitje pa marrë Certifikatë të Lejes të re, çdo herë që kërkon ta ribotojë tekstin e miratuar me ndryshime që e kalojnë 15% të masës së tij, ose që prekin nenet 2 e 3 të kësaj kontrate. Të mos e ribotojë tekstin, nëse këto ndryshime çënojnë parimet bazë morale apo kombëtare mbi të cilat është ndërtuar shkolla shqiptare, të pasqyruara në Kushtetutë dhe në ligjin “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar”.
6. Të mos fusë në tekst material reklamues të çdo lloji për veten ose këdo biznes apo veprimtari tjetër.
7. Të përmbushë standardet e cilësisë të parashikuara në Certifikatën e Lejes, në përputhje me nenet 2, 3 e 6/B6 të kësaj kontrate, në çdo kopje që del në shitje.
8. Të vendosë ISBN-në, çmimin, barkodin dhe simbolin e BOTUESIT në kopertinën e tekstit dhe të pajisë çdo kopje të tij me pullën me hologramë të certifikimit përpara nxjerrjes së tekstit në treg. Botuesi detyrohet të pranojë inspektimin e MASH-it për të verifikuar vendosjen e krejt sasisë së pullave që ka blerë nga MASH-i përpara se ta nxjerrë në shitje sasinë e teksteve ku ka përdorur pullat.
9. Të dërgojë, brenda datës 04 qershor 2008, në të gjitha shkollat nëpërmjet DAR/ZA-ve nga një kopje të tekstit alternativ për përzgjedhje, pasi të pajiset me Certifikatën e Lejes.
10. Të shesë tekstet e certifikuar në mjedise shkollore. Në qytete, të cilat kanë librari, shitja e teksteve mund të bëhet edhe në librari.
11. Të pranojë porosi nga shkollat për llogari të nxënësve si blerës, për plotësimin e nevojave të vitit të ardhshëm shkollor 2008-2009.
12. Të kryejë me mjetet e tij shpërndarjen e teksteve drejtpërdrejt në shkolla /librari sipas një gjeografie të përcaktuar nga MASH-i në të gjithë vendin dhe sipas planifikimit të porosive të shkollave. Shpërndarja të përfundojë deri më 31 gusht 2008.
13. Të fillojë shitjen e teksteve shkollore më 01 shtator 2008, duke furnizuar sasinë

- e plotë të porositur.
14. Të mos e nxjerrë në shitje të lirë tekstin jashtë sistemit konkurrues të përzgjedhjes në shkolla, pa furnizuar nxënësit në shkolla e /librari me sasi të planifikuara për shkollat, të konfirmuar nga drejtori i shkollës përkatëse.
 15. Të shesë me lekë në dorë nxënësve tekstet e porositura nga shkollat, në shkolla/librari nëpërmjet personave të kontraktuar, sipas gjeografisë së përcaktuar nga MASH-i. Nëse teksti është për shkolla të pakicave kombëtare ose shkolla të mesme profesionale, sasia e teksteve e porositur të çohet në shkollë e shoqëruar me faturën tatimore.
 16. Për librat e shitur me lekë në dorë, blerësit t'i lëshojë dokumentin e shitjes ose faturë të kasës fiskale, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave.
 17. Të mos e shesë tekstin si pjesë e ndonjë pakoje (me tekste të tjera, fletore, materiale mësimore etj.), gjë që rrit artificialisht çmimin dhe e detyron konsumatorin të paguajë më shumë.
 18. Të mos veprojë ndryshe nga mënyra e përcaktuar në këtë kontratë për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e tekstit për të cilin ka marrë Certifikatën e Lejes.
 19. Të rregullojë me kontratë plotësimin e detyrimeve të mësipërme kur ka të tretë.

Neni 7

VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë është e vlefshme për vitin shkollor 2008-2009.

Neni 8

SANKSIONET

1. Pas nënshkrimit, kjo kontratë nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga BOTUESI. Në rast se kjo ndodh, MASH-it i lind e drejta të përjashtojë BOTUESIN nga e drejta për të marrë pjesë në sistemin e miratimit të teksteve dhe BOTUESI detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar MASH-it nga prishja e kontratës. Llogaritja e dëmit bëhet nga MASH-i. Njëkohësisht, BOTUESI detyrohet që t'ia kalojë, përkundrejt vleftës, të drejtat e botimit, shpërndarjes dhe shitjes së këtij teksti një botuesi tjetër, i cili u nënshtrohet të gjitha detyrimeve të kësaj kontrate për aq kohë sa është e vlefshme Certifikata e Lejes.
2. MASH-i nuk mund ta zgjidhë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, përveç rasteve kur konstatohen shkeljet dhe mosplotësimi i detyrimeve të botuesit të përmendura në këtë kontratë. Nëse MASH-i e prish kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar BOTUESIT.
3. Për shkeljet të paktën të një prej paragrafeve të nenit 6 të kontratës nga BOTUESI, ai përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim në të ardhmen pranë MASH-it në BOMIT për aq kohë sa ta gjykojë MASH-i. Njëherësh, ai ngarkohet t'i paguajë MASH-it penalitetin prej 1000000 lekë.

Neni 9

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, zgjidhja e tyre bëhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqsor të Tiranës.

Neni 10
TË PËRGJITHSHME

PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

PËR SHTËPINË BOTUESE

Kjo kontratë nënshkruhet në 3 (tri) kopje origjinale, nga të cilat 2 (dy) i merr MASH-i dhe 1 (një) BOTUESI. Kjo kontratë hyn në fuqi, pasi nënshkruhet nga të dyja palët.

Aneks 5.2. Udhëzues vlerësimi për tekstet mësimore

Përshtatur nga:

Davies, B. (1995). Gender Bias in School Text Books. London, UK: Commonwealth Secretariat. pp.81-94.

Ky seksion është përgatitur për t'i ardhur në ndihmë kujtdo që planifikon apo ka ndërmarrë tashmë nisma vlerësimi të paragjykimeve mbi përkatësinë gjinore, të cilët gjenden në librat shkollorë si dhe në materiale të tjera të përdorura në klasat e shkollave fillore dhe të mesme. Udhëzuesi synon të mbështesë mësuesit, autorët e teksteve shkollorë, vlerësuesit e teksteve shkollorë, nxënësit, si dhe përfaqësuesit e shtëpive botuese. Udhëzuesi mund të përdoret edhe nga individë të interesuar për çështje të përkatësisë gjinore dhe arsimit, ekspertë të fushës, studiues etj.

Udhëzuesi shoqërohet edhe me një sërë Fletësh Vlerësimi. Ato janë përpiluar për të ndihmuar në identifikimin e elementeve pozitive dhe negative të secilit tekst shkollor/mësimor. Për lehtësi, vlerësimi është organizuar në pika pozitive në anën e majtë të kolonës dhe në pika negative në anën e djathtë të saj. Thjesht, vendosni një plus (+) apo minus (-) në kutitë e duhura në Fletën e Vlerësimit për mënyrën sesi e vlerësoni ju secilën nga këto çështje. Këto çështje përfshijnë: (1) dukshmërinë (e grave dhe vajzave), (2) stereotipizimin (lidhur me karakteristika të secilit seks, marrëdhëniet dhe punësimin), (3) respektin e barabartë, (4) fjalorin e ndjeshëm ndaj çështjeve të përkatësisë gjinore, (5) ilustrimet dhe (6) autoritetin.

1. Dukshmëria

Vendosni një plus nëse:

- A. Numri i personazheve femërore në tekst dhe ilustrimet janë të paktën të barabartë me personazhet mashkullorë.
- B. Karakteri kryesor femëror përmendet të paktën po aq shpesh sa karakteri kryesor mashkullor.

Vendosni një minus nëse:

- C. Më shumë personazhe mashkullorë se femërorë në tekst dhe në ilustrime.
- D. Karakteri mashkullor kryesor përmendet më shpesh sesa ai femëror.

2. Stereotipizimi

(i) Karakteristikat

Vendosni një plus nëse karakteret femërore përgjithësisht paraqiten si:

- A. Të guximshëm, asertivë, të pavarur, krijues, me iniciativë dhe vetë-kontroll.

Vendosni një minus nëse karakteret femërore paraqiten si:

- C. Të dobët, me frikë, ndjekës të vazhdueshëm, të nënshtruar, të varur etj.

Vendosni një plus nëse karakteret mashkullore përgjithësisht paraqiten si:

- B. Të dhëmbur, të ndjeshëm, të paqartë, kanë nevojë për t'u qetësuar, përkujdesës dhe me frikë.

Vendosni një minus nëse karakteret mashkullorë paraqiten si:

- D. Agresivë, tiranë, të pakujdesshëm, mashtrues, kanë gjithmonë të drejtë, etj.

(ii) Marrëdhëniet

Vendosni një plus nëse çështjet e mëposhtme gjenden në tekste:

Vendosni një plus nëse çështjet e mëposhtme gjenden në tekste:

- A. Njerëz të vetmuar, marrëdhënie të të njëjtit seks.
- B. Vajzat dhe djemtë në kujdes të një mashkulli të rritur.
- C. Vajzat janë kompetente dhe vlerësohen të tilla nga djemtë.
- D. Vajzat shfaqen në pozicione drejtuese në varësi të vajzave apo djemve.
- E. Pjesa më e madhe e karaktereve paraqiten në çifte femër-mashkull.
- F. Ka gjithmonë një femër të rritur që kujdeset për fëmijët.
- G. Nuk ka drejtuese gra apo vajza.
- H. Djemtë flasin në vetën e parë (unë, mua) më shpesh se vajzat.
- I. Vajzat flasin në vetën e dytë (ti, ju) më shpesh se djemtë.

(iii) Punësimi

Vendosni një plus nëse karakteret femërore paraqiten si:

- A. Pjesëmarrës aktivë dhe pozitivë në veprimtari jotradicionale. si p.sh: lundrim, rrëshqitje mbi dallgë, udhëtime pushimesh, çiklizëm, ngarje e makinës etj.

- B. Në profesionet që tradicionalisht nuk zihen nga gratë.

(“ajo

- C. Në një rang të gjerë Profesionesh, që zihen nga burrat.

- D. Në një nivel të lartë apo pozicion menaxherial.

Vendosni një minus nëse autori/ja:

- M. Nënkupton që është diçka negative në një familje nëse nëna punon jashtë shtëpisë.

- N. Nënkupton që punësimi i një gruaje është suplementar (shtesë), apo privilegj i veçantë (“bashkëshorti e lejon atë të punojë”) apo është habitës

aktualisht ka biznesin e saj”).

- O. I zhvlerëson punët e shtëpisë (“jam vetëm një amvisë”) apo i lavdëron ato si roli i gruas (“detyra e vërtetë dhe e vetme e gruas është të bëjë punët

- e shtëpisë”).
- E. Si nëna të punësuarja jashtë shtëpisë.
- F. Me një zgjedhje rreth martesës.
- G. Në një sërë veprimtarish të mirëmbajtjes së shtëpisë, si: pagesa e faturave, riparimi i makinerive, ndërtim, rregullimi i tubacioneve etj.
- H. Kanë dhe ushtrojnë të njëjtat mundësi për të luajtur njësoj si djemtë si dhe për zhvillimin e shprehive.
- I. Angazhohen në veprimtari që zhvillojnë shprehi për punësimin e ardhshëm, p.sh. lojë energjike dhe zgjidhje e problemeve.

Vendosni një plus nëse karakteret mashkullore paraqiten:

- J. Duke i ofruar mbështetje grave në pozicione drejtuese.
- K. Duke ndarë rregullisht përgjegjësi për rritjen e fëmijëve dhe bërjen e punëve të shtëpisë.
- L. Duke marrë pjesë në subjekte të asociuara tradicionalisht me gratë dhe vajzat, si: gatimi, qepja, apo veprimtari të tjera, si: letërsia, arti apo sekretari.

3. Respekt i barabartë

Vendosni një plus nëse gjeni një nga çështjet e mëposhtme:

- A. Përfaqësohen pikëpamjet e njerëzve jo të privilegjuar, p.sh: njerëzit e një origjine të ndryshme racore, të gjymtuar, njerëz të varfër etj.
- B. Jetët e njerëzve trajtohen si me vlerë të barabartë, pavarësisht seksit, pasurisë, vendit, etnisë, besimit fetar, apo mjedisit shoqëror.
- C. Përvojat e grave vlerësohen vetëm mbi bazat e aktiviteteve tradicionale apo jo-tradicionale.

Vendosni një minus nëse autori/ja:

- G. Injoron gratë dhe nuk merr parasysh aktivitetet dhe arritjet e tyre.
- H. Përfaqëson vetëm gratë si të lidhura me rolet e tyre “tradicionale”, si bashkëshorte, nëna, motra apo vajza.
- I. Përdor interesat e burrave dhe përcakton përmbajtjen dhe strukturën e librit (p.sh.: historia rrëfëhet kryesisht duke u përqendruar tek lufta).

- D. Përmenden gra që kanë luajtur një rol në histori, politikë, apo në jetën komunitare të vendit.
- E. Shprehje të thëna nga gratë apo vajzat, dëgjohen dhe merren seriozisht.
- F. Tregon për historinë, gjeografinë, apo bujqësinë, etj., duke u fokusuar në atë çfarë gratë kanë bërë apo janë duke bërë.
- J. I përshkruan burrat dhe gratë në bazë të statusit të tyre martesor, kur ky i fundit nuk ka të bëjë fare me çështjen që po diskutohet.
- K. Supozon që gratë janë prona dhe përdor gjininë apo statusin martesor për të cilësuar arritjet e tyre (p.sh.: “Zonja X, bashkëshorte e Zotit X dhe nënë e pesë fëmijëve, ishte presidente e.....”).
- L. Në përshkrimin e grave apo vajzave, fokusohet në cilësitë e tyre fizike apo lidhjen me burrat në një formë “pronësie”.
- M. Në përshkrimin e burrave në shtëpi, pranon varësinë e tyre nga gratë në lidhje me vaktet, apo ngathtësinë dhe gabimet e tyre në punët e shtëpisë.
- N. Pranon thënie stereotipizuese të tilla, si: biondja, kaçurrelja, flokëkuqja, pulë e lagur, zonja të vogla, vajzë e ngarkuar me detyra etj.

4. Fjalor i ndieshëm ndaj çështjeve të përkatësisë gjinore

Vendosni një plus nëse autori:

- A. Përdor përemra kur u referohet grave dhe vajzave.
- B. Përdor “burrë” nëse i referohet vetëm personave meshkuj.

Vendosni një minus nëse autori:

- F. Përdor përemra mashkullorë për t’u referuar si grave, ashtu edhe burrave.
- G. Përdor fjalën “burra” nëse i referohet grave dhe burrave.

- C. Përdor parashtesa dhe prapashtesa të sakta (si: grua në biznes /businesswoman etj.).
- D. Përdor tituj neutralë gjinorë apo specifikë gjinorë për profesione (si: punonjës poste, person që merret me tregëti, apo grua police).
- H. Përdor fjalën “burrë” si prapashtesë (si p.sh. burrë në biznes/ businessman kur nuk i referohet domosdoshmërisht burrave.
- I. Përdor tituj mashkullorë për profesione (si: postier, doktor, shitës, polic, shofer etj.) edhe në rastet kur personazhet nuk janë domosdoshmërisht meshkuj.

5. Ilustrimet

Vendosni një plus nëse:

- A. Ka një numër të barabartë personazhesh mashkullorë dhe femërorë.
- B. Personazhet femërore në profesione zakonisht të rezervuara për meshkujt.
- C. Femrat portretizohen në veprimtari zakonisht të rezervuar për burrat.
- D. Burrat shfaqen më mbështetës.
- E. Ngjashmëria midis karaktereve femra dhe meshkuj është më e dukshme sesa ndryshimet mes tyre.
- F. Karakteret mashkullore dhe femërore kanë veshje me ngjyra të njëjta dhe mundësisht të njëjtin stil veshjeje.

Vendosni një minus nëse:

- G. Fëmijët femra portretizohen përgjithësisht më të vogla se fëmijët meshkuj.
- H. Burrat janë përgjithësisht më dominantë sesa gratë.
- I. Femrat përgjithësisht portretizohen në situata shtëpiake apo familjare.
- J. Karakteret janë përgjithësisht të përfaqësuar në çifte mashkull - femër.
- K. Karakteret meshkuj përfaqësohen në foto, ndërsa karakteret femra në piktura.
- L. Gratë dhe vajzat shfaqen si mendjellehta dhe të paafta.

6. Autoriteti

Vendosni një plus nëse:

- A. Autori/ja i drejtohet në mënyrë të qartë studentit/es në tekst, si një person me një këndvështrim të vetin.
- B. studenti/ja inkurajohet që ta shikojë çështjen për diskutim nga këndvështrime të ndryshme.
- C. Autorja është grua.
- D. Teksti inkurajon studentët të vlerësojnë shprehje, bazuara në përvojën e tyre.
- E. Ka informacion rreth autorëve dhe përgatitjes së tyre profesionale.

Vendosni një minus nëse:

- G. Autori/ja shkruan sikur këndvështrimi i tij/saj është i saktë dhe i vetmi i mundshëm.
- H. Në libra të shkruar nga grup autorësh, shumica janë burra.

7. Vlerësimi i ndjeshmërisë gjinore në tekste specifike mësimore

7.1 Matematika

Vendosni një plus nëse autori/ja:

- A. U jep vajzave përgjegjësi me sasi të mëdha parash.
- B. U tregon vajzave dhe djemve dëshirë për të bashkëpunuar në zgjidhjen e problemeve.
- C. Tregon që vajzat e pëlqejnë matematikën.
nga
- D. Paraqet shembuj lidhur me jetën e përditshme të studentëve.

Vendosni një minus nëse autori/ja:

- E. Përgjithësisht u jep sasi të mëdha parash djemve dhe jo vajzave.
- F. I paraqet vajzat si të paafta të zgjidhin probleme matematikore.
- G. Paraqet shembuj, të cilët përgjithësisht burojnë aktivitete dhe interesa të “djemve”.

7.2 Shkencat shoqërore

Vendosni një plus nëse:

- A. Kulturat shfaqen në ndryshim dhe në zhvillim e jo si statike.
- B. Historitë tregohen si të bazuara në jetët e njerëzve “të zakonshëm”, të cilat paraqiten me vlera të mëdha.
- C. Kulturat jodominante paraqiten me respekt.
- D. Autori/ja inkurajon nxënësit të ekzaminojnë ndryshimet midis njerëzve dhe të kuptojnë nga burojnë ato.

Vendosni një minus nëse:

- E. Mitet rreth përkatësisë gjinore prezantohen si fakte, apo si të pashmangshme.
- F. Historitë që tregohen bazohen vetëm në jetët e njerëzve “të mëdhenj/të shquar”.
- G. Jeta qytetare portretizohet si superiore apo si mënyra e vetme e jetesës.

7.3 Shkencat dhe teknologjia

Vendosni një plus nëse:

- A. Teksti i udhëzon nxënësit si të pyesin lidhur me çështje për të cilat duan përgjigje.
- B. Teksti i udhëzon nxënësit sesi të kërkojnë për pyetje dhe të zgjedhin përgjigje.
- C. Autori/ja nxit nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike rreth supozimeve, procedurave dhe gjetjeve, si në fushën e shkencës, ashtu edhe të teknologjisë.

Vendosni një minus nëse:

- D. Teksti paraqet një sërë “të vërtetash” shkencore në një Mënyrë, që i bën ato të padiskutueshme.
- E. Vajzat tregohen si jo shkencëtare.
- F. Shkenca dhe teknologjia shfaqen si fusha tërësisht mashkullore.
- G. Problemet dhe shpjegimet janë abstrakte dhe jo të lidhura me jetën e përditshme të fëmijëve.

VLETË VLERËSIMI

Autori/ja/:

Titulli:

Edicioni:

Subjekti:

Gjuha:

Botuesi:

Grupi i synuar:

Lloji i materialit:

Viti:

PJESA I

Vlerësimi sasior

<i>Çështjet</i>	<i>Pluset</i>	<i>Minuset</i>	<i>Totali 1</i>	<i>Totali 2</i>
1. Dukshmëria	A B <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Stereotipizimi	A B <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Karakteristikat</i>	A B C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	E F G H I <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Marrëdhëniet</i>	A B C D E F <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	M N O P <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Profesionet</i>	G H I J K L <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Respekti i barabartë	A B C D E F G H I J K L M <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Fjalori i ndieshëm gjinor	A B C D E F G H I J K L M <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Ilustrimet	A B C D E F G H I J K L M <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Autoriteti	A B C D E F <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	G H <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Vlerësimi i ndieshmërisë gjinore në tekste specifike mësimore				
<i>Matematika</i>	A B C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	E F G <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shkencat shoqërore</i>	A B C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	E F G <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<i>Shkenca dhe teknologjia</i>	A B C D <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	E F G <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
TOTALI PËRFUNDIMTAR			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

PJESA II
Vlerësimi Cilësor

5

1. A i plotëson ky tekst idealet e: (rrethoni përgjigjen e saktë lidhur me vlerësimin tuaj)
- a) Gjuhë joseksiste? Po/Jo/Pjesërisht.
 - b) Të drejta të barabarta për të gjithë individët? Po/Jo/Pjesërisht.
 - c) Respekt për diversitetin tek individët dhe grupet? Po/Jo/Pjesërisht.
 - d) Ofrimi i ideve dhe informacionit që lejon dhe inkurajon nxënësit që të vënë në pyetje pabarazinë:

- (i) midis meshkujve dhe femrave? Po/Jo/Pjesërisht.
- (ii) midis kulturave? Po/Jo/Pjesërisht.

2. Ky tekst do të mund të përmirësohej në disa pjesë të veçanta dhe ilustrime të tij. **PO/JO**
Veçanërisht _____

3. Ky tekst, në pamje të parë duket i pranueshëm, por ka disa probleme serioze që kërkojnë një rishikim të detajuar. **PO/JO**
Shembuj: _____

4. Ky tekst ka përmbajtje seksiste, është jokorrekt dhe ofendues, si edhe jep mesazhe të gabuara. Për rrjedhojë, ai nuk duhet përdorur. **PO/JO**
Shembuj: _____

Komente të tjera.

Ky tekst (zgjidhni një nga alternativat):

- Rekomandohet të përdoret
- Ka nevojë për disa rishikime
- Nuk duhet të përdoret

Teksti u vlerësua nga: _____ Titulli: _____

Pozicioni: _____

Organizata: _____ Data: _____

Aneks 5.3. Koncepte të tjera dhe përkufizime mbi përkatësinë gjinore dhe zhvillimin

Përkatësia gjinore/ gender: I referohet mundësi dhe attributeve sociale të lidhura me faktin e të qenit burrë apo grua, vajzë apo djalë, po ashtu edhe marrëdhënieve mes grave dhe burrave. Përkatësia gjinore përcakton çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet te një grua apo një burrë në një kontekst të dhënë.¹⁰

Stereotipat gjinore: Janë përgjithësime, skema për cilësitë dhe karakteristikat e anëtarëve të një kategorie ose grupi social të caktuar. Stereotipat në përkatësinë gjinore përfshijnë cilësitë e personalitetit që mendohet se janë tipike për meshkujt dhe femrat. Ato përfshijnë gjithashtu role profesionale dhe sociale që konsiderohen si parësore për meshkujt dhe femrat në një shoqëri të caktuar. *Stereotipat gjinorë janë mekanizma të ndryshëm shoqërorë që i mësojnë nxënësve mashkulloren dhe femëroren e personalitetit dhe i bëjnë ata të brendësojnë sjelljen, qendrimet dhe rolet.*¹¹

Ndarja gjinore e punës: I referohet përcaktimit të roleve, përgjegjësi dhe detyrave të ndryshme burrave dhe grave, bazuar në idetë shoqërore të asaj çfarë burrat dhe gratë duhet të bëjnë dhe janë të aftë të bëjnë. Detyra dhe përgjegjësi të ndryshme u caktohen vajzave dhe djemve, grave dhe burrave sipas roleve të tyre seks - gjini, dhe jodomosdoshmërisht sipas aftësive ose preferencave të tyre personale. E gjithë puna dhe aktivitetet mund të ndahen në tri kategori: *prodhuese, riprodhuese dhe punë komunitare.*¹²

Ndarja prodhuese/riprodhuese ose dyzimi publik/privat, ilustron ndarjen gjinore të punës. *Prodhimi*, i cili është puna e paguar e kryer jashtë shtëpisë dhe në fushën publike, zakonisht, u atribuohet meshkujve për shkak të rolit të tyre si siguresit parësorë të “bukës së familjes”. *Riprodhimi*, nga ana tjetër, është puna e papaguar e kryer brenda shtëpisë, që u caktohet kryesisht grave dhe që mund të përfshijë detyra të tilla, si: mirë-mbajtjen e shtëpisë, kujdesin për fëmijët, të ushqyerit e tyre dhe të anëtarëve të tjerë të familjes.

Ngarkesë e dyfishtë/shumëfishtë: Është një situatë, që i referohet ngarkesës së punës që kanë gratë, si dhe detyrave të shumëfishta të tyre, e cila nëse llogaritet me numër orësh shkon më tepër se 24 orë në ditë. Kjo ngarkesë konsiston në *punën riprodhuese të papaguar, punën prodhuese të paguar, aktivitetin komunitar* dhe të gjithë punën e nevojshme për mbijetesën e familjes. Roli tradicional i gruas, sidomos nëse ajo është bashkëshorte apo nënë, është të qëndrojë në shtëpi, të merret me punët e shtëpisë dhe të kujdeset

¹⁰ Manuali i Trajnimit - Niveli Fillestar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

për pjesëtarët e familjes. Sidoqoftë, për shkak të situatës ekonomike, gjithnjë e më shumë gratë janë futur në tregun e punës. Ndërkohë, megjithëse ato shpenzojnë të njëjtat orë pune me burrat, duke punuar jashtë shtëpisë, punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët janë çështje, që i përkasin vetëm grave. Si rezultat, gratë mbajnë mbi supë një ngarkesë të dyfishtë si përsa i përket kohës, ashtu edhe përgjegjësisë. Prej tyre pritet, gjithashtu, që të marrin pjesë në aktivitete socio-kulturale, të tilla, si aktivitete fetare, aktivitete komunitare, në shoqërinë civile etj. Puna e grave të shtëpi, në forcën e punës dhe në komunitet është një ngarkesë e shumëfishtë, të cilën meshkujt nuk e kanë.¹³

Nëse një gruaje do t'i kërkohet të përshkruante jetën e saj, ka shumë mundësi që ajo të bëjë këtë nëpërmjet llojit të punës që ajo bën, nevojat imediate të familjes së saj, si: uji i pijshëm, ushqimi, edukimi i fëmijëve, si edhe vendi ku jeton. Pozicioni i saj, nga ana tjetër, karakterizohet nga pabarazia në pagë dhe punësim mes burrave dhe grave, pjesëmarrja në veprimtari politike, statusi ekonomik, politik dhe social në shoqëri, ekspozimi ndaj varfërisë, dhunës e kështu me radhë.

Rolet e shumëfishta të grave: Përfshijnë rolin riprodhues, prodhues, menaxhimin në komunitet dhe rolet politike që u kanë fituar. Roli riprodhues përfshin lindjen, rritjen e fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë. Roli prodhues përfshin aktivitete për të fituar të ardhura, si në sektorin formal, ashtu edhe në atë informal. Rolet komunitare kryesisht përfshijnë aktivitete me bazë vullnetare. Roli i grave në politikë përfshin pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes dhe në organizata të të gjithë niveleve qeverisëse dhe të shoqërisë civile.

Aktivitetet dhe profesionet që paraqiten në tekstet e shkollës fillore mund të kategorizohen në:

- (i) **punë apo veprimtari prodhuese** (veprimtari që kryhen për prodhimin e të mirave materiale dhe sjellin të ardhura) ku vihet re ndarja gjinore përsa i përket profesioneve "mashkullore" dhe "femërore";
- (ii) **veprimtari riprodhuese** (të cilat sigurojnë vazhdimësinë e familjes) të tilla, si: kujdesi për anëtarët e familjes, të gatuarit, pastrimit etj.;
- (iii) **veprimtari komunitare** (veprimtari që realizohen në komunitet) nga të cilat përfiton i gjithë komuniteti. (veprimtari që kryhen për prodhimin e të mirave materiale dhe sjellin të ardhura) ku vihet re ndarja gjinore përsa i përket profesioneve "mashkullore" dhe "femërore";

Dyzimi publik/privat: Është një dallim që shërben për të ruajtur ndarjen e ekonomisë në funksione prodhuese dhe riprodhuese. Puna prodhuese ndodh

¹³ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

në zonën publike dhe asaj i jepet një vlerë. Të mirat materiale dhe shërbimet në të sektor njihen më së miri, llogariten dhe paraqiten në statistika zyrtare. Puna riprodhuese në sferën familjare nuk ka asnjë vlerë dhe konsiderohet thjesht si mbështetje ndaj kërkesave të personave të sektorit prodhues. Sfera publike zakonisht konsiderohet si “arena” e burrave, të cilët mendohet se kanë statusin parësor në shoqëri, sepse ata konsiderohet se kryejnë funksione kryesore në shoqëri. Shfaqja e meshkujve në sektorin publik të shoqërisë e bën atë gjininë mbizotëruese në të gjitha fushat e jetës. Ata janë të aftë të marrin pjesë plotësisht në sferën ekonomike, politike dhe kulturore. Gratë, nga ana tjetër, mbeten të lidhura me sferën private dhe të shtëpisë. Ato marrin përsipër funksionet riprodhuese, të cilat konsiderohen si punë dytësore.

Veprim/diskriminim pozitiv: Është një veprim politik që favorizon grupet më të margjinalizuara të shoqërisë, siç janë gratë. Edhe pse është një masë e veçantë, nuk konsiderohet si diskriminuese, meqë ka si qëllim të përshpejtojë arritjen e barazisë mes grupeve dominante dhe atyre të margjinalizuara. Veprimi pozitiv nuk duhet të rezultojë në standarde të pabarabarta ose të ndara, por të vazhdohet edhe kur janë realizuar objektivat e barazisë dhe mundësive të barabarta. Si shembull i një veprimi të tillë shërben caktimi i grave në 50 % të pozicioneve më të larta burokratike, si një tregues se ekzistojnë kushte të caktuara socio-politike, të cilat i pengojnë gratë që të arrijnë pozicione të tilla.¹⁴

Diskriminim: Është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme, në bazë të racës, klasës, seksit dhe statusit kulturor të tyre. Kjo ka të bëjë me të gjitha praktikat, politikat ose procedurat që mohojnë trajtimin e barabartë të një individi ose grupi.¹⁵

Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, konsiderohet si përjashtim, pengesë apo dallim i bërë në bazë të seksit, që ka qëllim apo efekt mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore.

Feminizëm: Është një lëvizje mbarëbotërore, e cila kërkon të rrisë statusin politik, ekonomik dhe social të grave, dhe lufton për barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë. Koncepti themelor i feminizmit vazhdon të zhvillohet në përshtatje me kontekstin socio-ekonomik, politik dhe kulturor, në të cilin ndodh lëvizja.¹⁶

¹⁴ Manuali i Trajnimit - Niveli Fillestar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Përkatësia gjinore dhe zhvillimi - koncepte dhe përkufizime. Botim i Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim. PEGI, Tiranë 2004.

Barazia gjinore kundrejt drejtësisë gjinore: Me barazi gjinore/ mundësi të barabarta nënkuptojmë faktin që burrat dhe gratë gëzojnë status dhe kushte të njëjta, si dhe kanë mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social dhe kulturor të vendit të tyre. Ata/ato gjithashtu, duhet të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga rezultatet e këtij zhvillimi. Drejtësia gjinore shkon më tej një fokusi të trajtimit të barabartë. Kjo do të thotë t'u japësh atyre që kanë më pak në bazë të nevojave të tyre dhe të hedhësh hapa më tej duke kompensuar disavantazhet historike dhe sociale që shmangin burrat dhe gratë nga funksionimi në të njëjtin nivel. Drejtësia lidhet me mjetet, kurse barazia është rezultati final. Drejtësia çon në barazi. Shoqëri e drejtë nga pikëpamja gjinore. *“Është një shoqëri në të cilën gratë dhe burrat ndajnë në mënyrë të barabartë përgjegjësitë, pushtetin, autoritetin dhe vendimmarrjen.”*¹⁷

Seksizmi: Është sistemi dhe praktika e diskriminimit të një individi në bazë të seksit që ka.¹⁸ Paragjykimi ndaj grave, konsiderimi i tyre si nën stereotipa, përcaktimi në bazë të mundësisë së tyre seksuale dhe si joshje për meshkujt, si dhe të gjitha supozimet/teoritë që çojnë në trajtimin e grave si një qenie joplotësisht njerëzore.

Në shumicën e shoqërive ka diferenca dhe pabarazi midis grave dhe burrave, përsa u përket përgjegjësisë që u caktohen, aksesit ndaj dhe mbi burimet, si dhe mundësisë për të marrë vendime. Në këtë kontekst, foshnjës së sapolindur e derisa ai/ajo të rritet, do t'i atribuohet ajo çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet në një kontekst të dhënë. Pra, asaj/atij i caktohen pikërisht rolet, që do të "luajë në jetë".

Aksesi kundrejt kontrollit: Aksesi është mundësia e një personi për të përdorur burimet ose përfitimet aktuale politike, ekonomike dhe të shfrytëzimit të kohës. Kontrolli është aftësia për të përkufizuar përdorimin e burimeve dhe për t'ua imponuar këtë përkufizim edhe të tjerëve.

Aksesi i barabartë ndaj burimeve, përfitimeve dhe shërbimeve, është një nga objektivat e lëvizjes së grave për trajtim dhe mundësi të barabarta. Kontrolli i burimeve, përfitimeve dhe shërbimeve nga ana tjetër, shkon një hap më tutje. Ai ka të bëjë me aftësitë për të drejtuar ose ndikuar në mënyrën sesi duhet të kenë përfitime të njëjta, si gratë ashtu edhe burrat nga burimet përfitimet dhe shërbimet e ndryshme. Ndërkohë që burrat dhe gratë mund të kenë akses të njëjtë ndaj burimeve, përfitimeve dhe shërbimeve, kontrolli mund të jetë i kufizuar për një pjesë të vogël njerëzish ose vetëm për burrat, ose vetëm për gratë.¹⁹

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Manuali i Trajnimit - Niveli Fillestar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

¹⁹ Po aty.

Hapësirë gjinore: Është hapësira/hendeku midis grave dhe burrave, që nënkupton sesi ata përfitojnë nga edukimi, punësimi, shërbimet e kështu me radhë.²⁰

Ndjeshmëri gjinore: Ka të bëjë me aftësinë për të njohur çështjet e përkatësisë gjinore; për të njohur perceptimet e ndryshme të grave dhe interesat që dalin prej pozicionit të tyre të ndryshëm social dhe rolet gjinore. Ndjeshmëria gjinore shpesh përdoret për të treguar të njëjtën gjë si ndërgjegjësimi gjinor. Por në fakt ajo është fillimi i ndërgjegjësimit gjinor, i cili është më analitik dhe më kritik, ngre çështjen e pabarazive gjinore, dhe motivon individin të ndërmarrë veprime në përputhje me këto çështje.²¹

Inferioritet gjinor: Është nënshtrimi, ndonjëherë i shkaktuar nga forca apo dhuna, ose nën autoritetin e njërit seks. Ndodh tek gratë, të cilat nuk kanë kontroll mbi burimet e mundshme dhe që nuk kanë autonomi personale.²²

Margjinalizim: Ndodh atëherë kur gratë nuk konsiderohen si një forcë e rëndësishme ekonomike, pavarësisht rolit të tyre thelbësor në fushën prodhuese. Kontributet e tyre për zhvillim mbeten të pakonsideruara ose të nënvlerësuara. Metoda të ndryshme promovojnë pjesëmarrjen e grave në zhvillimin e një vendi përmes programeve tradicionale ose projekteve. Disa prej të cilave janë: përmirësimi i përkujdesit të nënës dhe fëmijës, ngritja e qendrave të kujdesit ditor për fëmijët dhe realizimi i aktiviteteve të të ushqyerit. Kjo prespektivë mbështet problemet e grave brenda hapësirave tradicionale, kështu që nevojat dhe potencialet e tyre në fusha të tjera, veçanërisht në sektorin ekonomik, mbeten të nënvlerësuara. Për pasojë, zhvillimi i plotë i grave, si një burim i rëndësishëm njerëzor, nuk është realizuar.²³

Patriarkalizëm: Është “rregulli i babait” ose një strukturë politike universale, që favorizon burrat dhe jo gratë. Fillimisht ky term është përdorur prej antropologëve për të përshkruar strukturën sociale në të cilën një burrë i moshuar, patriarku, ka pushtetin absolut mbi këdo tjetër në familje. Është dominimi mashkullor i pushtetit politik, i cili mban nën vete një sistem të padrejtë, në interes të atyre që vendosin rregullat dhe në kurriz të atyre që i zbatojnë këto. Në një sistem patriarkal burrat zënë vendet mbizotëruese dhe kanë kontroll mbi gratë. Burrat, si bashkëshortë dhe baballarë, ushtrojnë një autoritet të padiskutueshëm në jetën e grave dhe fëmijëve të familjes. Diferencat seksuale uzurpojnë të gjitha aktivitetet, përvojat dhe mundësitë.²⁴

²⁰ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

Interesa gjinorë kundrejt nevojave gjinore: Interesat gjinorë kanë të bëjnë me problemet që nxjerrin burrat ose gratë për shkak të pozicionit të tyre social, përmes roleve gjinore. Nevojat gjinore janë kërkesa të ndryshme të burrave dhe grave që vijnë si pasojë e dallimeve në rolet e tyre gjinore, llojit të punës që kryejnë, aksesin mbi burimet e shërbimet si dhe eksperiencave nga marrëdhënie të pabarabarta.²⁵

Nevojat gjinore praktike kundrejt atyre strategjike: Nevojat e grave dhe të burrave dalin nga rolet ekzistuese gjinore dhe janë të karakterizuara si domosdoshmëri praktike dhe strategjike. Ato ndeshen gjatë veprimeve të burrave dhe grave në kryerjen e roleve të tyre gjinore ekzistuese, në mënyrë më të lehtë. Nevojat gjinore strategjike ndeshen gjatë veprimeve që sfidojnë ose që nuk janë në përputhje me rolet gjinore ekzistuese. Trajtimi i nevojave të grave dhe të burrave mund të ndryshojë rolet gjinore ekzistuese.²⁶

Gratë në zhvillim (WID): WID u bë e njohur në fillimin e viteve 1970-të si një përfaqëse për përfshirjen e grave në zhvillim. Një përfaqëse ose një paradigme/model i zhvillimit, që fokusohet në marrëdhëniet midis grave dhe burrave dhe në procesin e zhvillimit. Ato bëjnë të njohur se burrat në ekonomitë në zhvillim, të cilët nuk kanë një status elitare, janë të prekur në mënyrë të ndryshme nga strukturat e pabarazisë brenda sistemit ndërkombëtar. Gjithsesi ato u kushtojnë shumë pak vëmendje marrëdhënieve sociale gjinore brenda klasave të ndryshme. Kërkimet dhe informacioni i grumbulluar gjatë Dhjetëvjeçarit të OKB-së për Gratë (1975-85) evidentoi varfërinë dhe disavantazhin ekzistues të grave dhe padukshmërinë e tyre në procesin e zhvillimit. Përgjigjet dhe ndërhyrjet e ndryshme të politikave u përqendruan mbi gratë si një grup i veçantë dhe rezultuan në shndërrimin e shqetësimeve të tyre në “shtesë” periferike ndaj përpjekjeve qendrore për zhvillim. Politikat dhe ndërhyrjet WID janë përqendruar kryesisht mbi punën prodhuese të grave. Dështimi për të vendosur një lidhje eksplicite me punën e tyre riprodhuese shpesh shton barrën e punës së grave. Të fokusohesh mbi gratë në izolim do të thotë që marrëdhëniet e pabarabarta gjinore në rrethana të ndryshme shoqërore dhe ekonomike të mbeten të patrajtuara.²⁷

Përkatësia gjinore dhe zhvillimi (GAD): Është një përfaqëse ose një paradigme, e cila fokusohet mbi forcat sociale, ekonomike, politike dhe kulturore, që përcaktojnë mënyrën sesi gratë dhe burrat marrin pjesë, përfitojnë dhe kontrollojnë në mënyra të ndryshme burimet dhe aktivitetet e tyre. Ajo drejtohet nga gratë si një grup, të marrëdhëniet e përcaktuara nga ana sociale midis burrave dhe grave. Përfaqësja “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi” (GAD) u shfaq për herë të parë më 1980 për të zëvendësuar

²⁵ Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

²⁶ Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

²⁷ Po aty.

përqasjen “Gratë në Zhvillim / Women in Development” (WID). “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi” merret me gratë po aq sa merret dhe me të mësuarit social të përkatësisë gjinore dhe me mënyrën e caktimit të roleve, përgjegjësi dhe pritshmëri të veçanta të grave dhe burrave. Ajo analizon natyrën e kontributit të grave, brenda kontekstit të punës, që bëhet si brenda, ashtu edhe jashtë shtëpisë, dhe reflekton mbi ndarjen publike/private, e cila nënvlerëson punën që bëhet nga gratë brenda shtëpisë.²⁸

Zhvillim: Mirëqenie e përmirësuar e një njeriu dhe procesi me anë të të cilit arrihet kjo. Kapaciteti mbështetës për të arritur një jetë më të mirë.²⁹

Fuqizim: Në kontekstin e zhvillimit, fuqizimi është një veprim individual ose kolektiv, me qëllim kapërcimin e pengesave që kanë ardhur nga pabarazia strukturale. Në një kuptim tjetër, fuqizimi nuk është vetëm një proces, por edhe një përfitim dhe/ose rezultat i një procesi.³⁰

Gjinizim: Të bësh pjesë, të përfshih apo të integrosh perspektivën gjinore në iniciativat e zhvillimit.³¹

Çështje gjinore dhe probleme gjinore: Shqetësime dhe probleme që vijnë si pasojë e roleve të ndryshme të grave/burrave dhe nga marrëdhëniet midis tyre. Detyrat dhe përfshirja, të cilat vijnë si pasojë e pritshmëri dhe perceptimeve të ndryshme mbi rolet e grave dhe burrave, që reflektohen dhe që sanksionohen nga ligji, politikat, procedurat, sistemet, programet, aktivitetet dhe projektet e qeverisë. Të gjitha këto janë pengesë për mundësi që duhet të kenë gratë në procesin e zhvillimit dhe në të përfituarit prej këtyre mundësive.³²

Analiza gjinore: Një mjet për të identifikuar statusin, rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave në shoqëri, ashtu si dhe seksin, dhe kontrollin e tyre mbi burimet, përfitimet, dhe mundësitë. Një strukturë me anë të së cilës krahasohen avantazhet dhe disavantazhet me të cilat përballen gratë/burrat në sfera të ndryshme të jetës, përfshi këtu dhe familjen, vendin e punës, shkollën, komunitetin dhe sistemin politik. Ai gjithashtu merr në konsideratë mënyrat sesi faktorë kulturorë, socialë, klasorë, racorë, etnik dhe faktorë të tjerë, ndërveprojnë me përkatësinë gjinore, duke dhënë rezultate diskriminuese. Ky është një grup standardesh që ndihmon të gjykohet për ndikimet e mundshme të përkatësisë gjinore mbi politikat, programet dhe projektet. Pra, një mënyrë e vazhdueshme për të hedhur vështrimin mbi ndarjen gjinore të punës dhe

²⁸ Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

²⁹ Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (2007). Paketë burimore mbi përkatësinë gjinore. Fjalorth Termash.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty.

³² Po aty.

aksesin e kontrollin që burrat dhe gratë kanë mbi inputet ose burimet e nevojshme për punën e tyre dhe përfitimet ose outputet e tyre prej saj.³³

Tregues gjinorë: Matës specifike që përdoren për të vlerësuar nëse janë plotësuar apo përmbushur objektivat gjinorë.³⁴

Statistika gjinore: Informacion dhe të dhëna, të cilat ofrojnë jo vetëm një krahasim midis grave dhe burrave, por në të njëjtën kohë, sigurojnë që pjesëmarrja dhe kontributi i grave dhe burrave në shoqëri është matur dhe vlerësuar në mënyrë të saktë.³⁵

Përfundimet e statistikave gjinore kërkojnë që të gjitha të dhënat zyrtare të cilat janë mbledhur mbi seksin, konceptet dhe metodat e përdorura për mbledhjen, dhe prezantimin e të dhënave, të reflektojnë në mënyrën e duhur çështjet gjinore, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët, që lindin si pasojë e paragjyqimeve gjinore.

Të dhëna të ndara sipas seksit: Informacion statistikor, si cili duke qënë i ndryshëm për gratë dhe i ndryshëm për burrat dhe lejon të shihen cilat janë boshllëqet në pozitat ose në kushtet e tyre.

Një shembull i këtyre të dhënave është numri i grave që punojnë, në raport me popullatën e përgjithshme që cilësohet si forcë pune.

Pabarazi gjinore strukturale: Një sistem i diskriminimit gjinor që praktikohet nga institucionet publike ose sociale, i cili bëhet më i theksuar kur sanksionohet nga rregullat dhe ligjet administrative sesa vetëm nga normat dhe tradita.³⁶

Integrim: Në kontekstin e "Përkatësisë Gjinore dhe Zhvillimit", një grup dominant idesh dhe drejtimeve të zhvillimit dhe të organizatave të ndryshme, të ndërlidhura me njëra-tjetrën me anë të të cilave merren vendime mbi shpërndarjen e burimeve dhe mbi mundësitë për zhvillim.³⁷

Integrimi kryesisht është i kontrolluar nga burrat dhe mund të përfshijë si më poshtë:

- drejtimet që ndjekin qeveritë në terma të shpërndarjes së burimeve te grupet sociale dhe ekonomike;

³³ Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (2007). Paketë burimore mbi përkatësinë gjinore. Fjalorth Termash.

³⁴ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

³⁵ Po aty.

³⁶ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

³⁷ Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

- këndvështrime mbi rolet gjinore në bazë të kulturës dhe të besimit fetar;
- axhendat e grupeve politike;
- praktikat e marrjes në punë dhe të pagesave në sektorin privat;
- marrëdhëniet e tregut global;
- praktikat dhe aktivitetet e institucioneve financiare të shumanshme, të tilla si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar si dhe të institucioneve të asistencës bilaterale.

Integrim gjinor: Një grup procesesh dhe strategjish, që synojnë të sigurojnë njohjen e problemeve gjinore mbi një bazë të qëndrueshme.

Një vlerësim i ndërlkimeve që kanë gratë dhe burrat nga veprime të planifikuara të qeverisjes, si: politikat, legjislacioni, programet dhe projektet.

Një strategji për të integruar shqetësimet dhe përvojat e grave dhe të burrave në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve, dhe projekteve në të gjitha axhendat politike, ekonomike dhe sociale.

Një përjasje që konkretizon problemet e barazisë gjinore në qendër të vendimeve politike, strukturave institucionale dhe shpërndarjes së burimeve, të cilat përfshijnë këndvështrimet dhe prioritetet e grave në marrjen e vendimeve në drejtim të qëllimeve dhe proceseve të zhvillimit.³⁸

Pjesëmarrje: Përfshirja direkt e grave të lëna në harresë në procesin e zhvillimit, për të formuar kapacitetin e tyre me qëllim që të kenë akses dhe kontroll mbi burimet, përfitimet dhe mundësitë, për të fituar një besim në vetvete dhe një nivel më të mirë jetese.

Në kontekstin e “Barazisë Gjinore dhe të Strukturës së Fuqizimit të Grave”, marrja pjesë në vendimmarrje, në drejtim të analizimit të mënyrës sesi janë bërë gjërat dhe si janë shpërndarë burimet.³⁹

Fuqizimi i grave: Në kontekstin e zhvillimit, një mjet dhe një strukturë që i lejon gratë të jenë pjesëmarrëse në përpjekjet për zhvillim dhe jo të jenë thjesht përfituese të tij. Kjo i bën ato të afta të marrin vendime në bazë të këndvështrimeve dhe perspektivave të tyre. Në kontekstin e “Barazisë Gjinore dhe të Strukturës së Fuqizimit të Grave”, fuqizimi i grave është qëllimi dhe procesi bazë për ecjen e tyre përpara. Ky është procesi me anë të të cilit gratë mobilizohen të kuptojnë dhe të tejkalojnë diskriminimin gjinor, ashtu si dhe të arrijnë një barazi në mirëqenie dhe një akses të barabartë ndaj burimeve.⁴⁰

³⁸ Manuali i Trajnimit - Niveli i Avancuar. Qendra e Gruas (i pabotuar). Tiranë, 2003.

³⁹ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

⁴⁰ Po aty.

Ndërgjegjësim për përkatësinë gjinore: Lidhet me aftësinë për të identifikuar problemet që dalin nga pabarazia dhe diskriminimi gjinor, madje edhe nëse këto nuk janë të dukshme në sipërfaqe, por të “fshehta”, ose nuk bëjnë pjesë në shpjegimin e përgjithshëm dhe të pranuar lidhur me çfarë dhe ku qëndron problemi. Ndërgjegjësimi gjinor nënkupton një nivel të lartë të vetëdijes gjinore.⁴¹

⁴¹ Ndjeshmëria Gjinore dhe Integrimi Gjinor. Fjalorth termash. OSCE. Përpiluar nga Elton Lelo, Civil Society Development and Gender Unit. 2004.

